# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM

# Për programin e studimit Specializim afatgjatë (SPA)

# në Kirurgji

**Eksperti i vlerësimit:**

**Prof.Dr.Ramazan Isufi**

**Dr. Alma Teliti**

**Dhjetor 2016**

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për programin e studimit Specializim afatgjatë (SPA) në Kirurgji**

| | Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit: | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Albanian University |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Shkencave Mjekësore |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Nr. 428 datë 05/09/2011 |
| 4 | Titulli i programit të studimit: | Specializim afatgjatë në Kirurgji (*) |
| 5 | Cikli i studimit: | Cikli Tretë |
| 6 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite (**) |
| 7 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 8 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 9 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 10 | Programi ofrohet nga institucioni | Universiteti Privat "Albanian University" |
| 11 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Ofrohet nga Institucioni |
| 12 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | JO |
| 13 | Diplomë e dyfishte (shëno emërtimin): | JO |
| 14 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 8 |
| 15 | Aktivizimi i programit të studimit | 2012 |
| 16 | Brezi i parë i diplomimit | 2015 (***) |
| 17 | Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit | 2012-2013 12 studentë<br>2013-2014 0 studentë<br>2014-2015 11 studentë<br>2015-2016 0 studentë<br>2016-2017 0 studentë |

Shënim: Tabelën e mësipërme e plotëson APAAL

*) Ky emërtim nuk përputhet me Standardet shtetërore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit, të Programeve SPA, miratuar me Urdhër të MASH, nr. 75, datë 13.02.2013. Emërtimi në Shtojcen1 të Standardeve është **SPA në Kirurgji orale.**

**) Kohëzgjatja e programit të studimit dhe kreditet totale nuk përputhen me kohëzgjatjen minimale të përcaktuar në Standardet shtetërore (dhe kreditet). Kohëzgjatja minimale në standard është 4 vite akademike (240 kredite)

***) Gjatë vizitës u deklarua se megjithëse brezi i parë i studentëve ka mbrojtur diplomën, studentët nuk janë pajisur akoma me diplomë.

**HYRJE**

Albanian University është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë. Ky institucion është licencuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Ky Universitet ofron programe të ciklit të tretë siç janë specializimet në fushën e stomatologjisë. Ky raport vlerësimi shqyrton ecurinë e programit, Specializim në Kirurgji Orale duke u fokusuar në misionin, kurrikulën, stafin akademik, politikat e formimit të studentëve, kërkimin shkencor, etj.

Programi i studimit është licencuar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.428 datë 05/09/2011 "Për hapjen e programeve të studimit cikli i tretë, studime specializuese afatgjata në Fakultetin e Stomatologjise të Universitetit Privat "Albanian University".

Në këtë urdhër, emërtimi i programit është SPA në "Kirurgji". Nga dokumentacioni i marrë në APAAL dhe nga vizita që Grupi i vlerësimit të jashtëm bëri në Institucion rezulton se ky emërtim është i pasaktë dhe nuk përputhet me misionin dhe objektivat e këtij programi studimi. Institucioni deklaron se ky program studimi është zbatuar si Kirurgji Orale dhe për këtë duhet të kishte kërkuar anulimin e Urdhërit të MASH dhe saktësimin e tij, gjë që nuk e ka bërë.

Ndërkohë me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 75, datë 13.02.2013, janë miratuar Standardet shtetërore për vlerësimin dhe akredimin e SPA në mjekësi. Krahasuar me këto standarde, ky program studimi ka *emërtimin*, *kohëzgjatjen* dhe *kreditet totale* jo në përputhje me këto standarde.

Përfundimisht, GVJ ka vlerësuar programin e studimit "SPA në Kirurgji", por faktikisht duke patur si objekt të vlerësimit të tij programin SPA në Kirurgji Orale.

Në këtë raport pasqyrohen përshkrimet analitike të situatës, treguesit e matshëm, dhe vlerësimi sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të jashtem, konkluzionet e arritura, si dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ngritjen e strukturave dhe nivelit të kërkimit shkencor në vitet e ardhshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtem organizoi disa takime për të realizuar procesin e vlerësimit dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të tij. Njëkohësisht u organizuan takime dhe biseda me anëtarë të tjerë të stafit të Fakultetit, sekretarinë mësimore si dhe departamentin e burimeve njerëzore për mbledhjen e informacionit të nevojshëm për procesin e vlerësimit të jashtem.

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVj:

1. Prof. Ramazan Isufi
2. Dr. Alma Teliti

Grupi i vlerësimit të jashtëm u shoqërua nga specialistët e APAAL Renata Qatipi dhe Xhiliola Bixheku.

Me date 18.01.2017, institucioni ka sjellë shkresë Nr. 06/1 Prot, "*Përgjigje për draft raportet e vlerësimit të jashtëm, për programet e studimit specializimet afatgjatë në Stomatologji në AU*", në të cilën ka bërë disa sqarime. GVJ pasi i lexoi ato, vendosi të ndryshojë raportin si më poshtë:

Tabela 7, faqe 24 u përditësua me dy të dhëna të reja nga AU: 1 Prof As u korgjua në Prof Dr dhe 1 Prof Dr u korigjua në Akademik.

Në faqen 17 fjalia plotësohet si më poshtë: Ne Departamentin e Stomatologjise gjate vizites sone ne konstatuam se ne sherbim te Programit te Specializimit te Kirurgjise Orale kishte vetem nje pedagog PAE kirurg oral me grade Doktor Shkencash. Personeli tjetër janë me tituj dhe grada shkencore, por jo në fushën e kirurgjisë orale.

Në faqen 23 Fjalia plotesohet si më poshtë: Per sa i perket stafit te brendshëm (PAE) për programin e specializimit Kirurgji Orale i udhehequr nga Prof.Dr. Akademik Anesti Kondili mendojme se nuk eshte i plote, për arsye se nuk është profesor në fushën e specializimit.

Në faqen 29 Fjalia plotësohet si më poshtë: Per sa i perket tutoreve ne konstatuam se jo te gjithe kishin eksperience 10 vjecare ne sferen e kirurgjise orale dhe aq me teper graden shkencore ne kete fushe, gje qe nuk perputhet me standartet aktuale te ketij programi.

Në faqen 8, është bërë një lapsus që u korigjua

Në faqen 15 është bërë një lapsus që u korigjua

Vërejtja për faqen 23, nuk u mor parasysh sepse flitet për dy gjëra të ndryshme

Në faqen 43 fjalia u plotësua si më poshtë: Në RVB Institucioni nuk kishte paraqitur nje raport financiar te detajuar per kostot e përfshira ne realizimin e programit te studimit ne Kirurgjine orale. GVJ i kërkoi edhe një herë të dhënat financiare në vite. Institucioni na vuri në dispozicion të dhënat e kërkuara si më poshtë.

Si rrjedhojë pika 3 e konkluzioneve u hoq

## PROGRAMI E STUDIMEVE, ADMINISTRIMI I TIJ, NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË

## 1. STANDARDI I - SYNIMET DHE QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT, KUADRI I PËRGJITHSHËM

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

Programi i studimeve është i pershtatur me strategjine per zhvillim te ketij programi.

Programi i studimit "SPA në Kirurgji" është zhvilluar në perputhje me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkences Nr.428 date 05/09/2011 per hapjen e programeve te studimit cikli i trete, studime specializuese afatgjata ne Fakultetin e Stomatologjise te Universitetit Privat "Albanian University", por termi "Kirurgji" nuk perputhet me standardet shtetërore për këtë program dhe emërtimi i saktë duhet të ishte *SPA në Kirurgji Orale.*

### Misioni dhe Objektivat e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe të programit të studimit

Programi i specializimeve në Kirurgji Orale i organizuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore pranë Albanian University i përket ciklit të tretë të studimeve në Shqipëri dhe ka si objektiv të përgjithshëm të përgatisë mjekë - specialistë në Kirurgji Orale. Per formimin specializues ky program realizohet nga nje staf akademik kryesisht me eksperte te huaj.

Ky program mendojme se i pajis specializantet me njohuri teorike dhe praktike te afte per te kryer intervente te kirurgjise dento-alveolare ne paciente. Gjithashtu mendojme se specializantet nen drejtimin e tutoreve mund te prezantojne raste klinike ne aktivitete shkencore kombetare dhe nderkombetare.

**Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit:** Programi i specializimeve në Kirurgji Orale i organizuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore pranë Albanian University i përket ciklit të tretë të studimeve në Shqipëri dhe ka si objektiv të përgjithshëm të përgatisë mjekë specialistë në Kirurgji Orale.

Formimi specializues karakterizohet nga përgatitja e nje stafi kombetar dhe nderkombetar. Gjatë zhvillimit të këtij programi konstatuam se përdoren pajisje elektro-mjekësore në të gjitha disiplinat e specializimeve me qëllim mësimin e teknikave operatore bashkëkohore. Specializantet nen udheheqjen e tutoreve kryejne intervente te kirurgjise dentoalveolare duke bere rrotacion tek i njejti pacient me aspekte te vecanta te teknikes operatore.

**Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin** Programi i studimit te specializimit ne Kirurgji Orale ka një kohëzgjatje 3-vjeçare për një total prej 180 ECTS. Krahasuar me standardet shtetërore kjo kohëzgjatje duhet të jetë 4 vite, me një total prej 240 kreditesh.

Programi i studimit udhëhiqet nga Drejtuesi i Programeve të Specializimit pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe koordinohet nga Koordinatori i këtyre programeve në bashkëpunim me stafin mësimdhënës, stafin administrativ dhe stafin mbështetës klinik.

**Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor:** Mesimdhenia realizohet duke integruar mesimin dhe kerkimin shkencor, duke e bere kete program te mundshem per pregatitjen e kirurgeve oral per tju pergjigjur nevojave te tregut te punes.

**Kërkimi shkencor në planin strategjik synon:** Mendojme qe ky program i krijon mundesi stafit akademik dhe specializanteve per te zhvilluar me tej kerkimin e tyre shkencor.

Duke thelluar njohurite dhe dijet, duke ngritur nivelin e mesimdhenies, mendojme qe keto profesionaliste janë te afte per t'i aplikuar ne zgjidhjen e situatave te ndryshme klinike.

**Tregues të matshëm:**

☑ Plani mësimor (shih Tabelën 1)

Tabela 1

Programi i Specializimit në Kirurgji Orale

VITI I

| Lloji i veprimtarisë | Modulet | ECTS | Orë gjithsej | Orë në auditor | Orë praktike | Orë jashtë auditorit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Lende të formimit të përgjithshëm | Anatomia e Kokës dhe e qafës | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Anatomia Radiologjike | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Histologji-Embriologji | 1 | 25 | 20 | - | 5 |
| | Biologji dhe Fiziologji e aplikuar | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Semiotikë e përgjithshme | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| Praktikë klinike 1 | Trajtim klinik i pacientit | 8 | | - | 200 | - |
| Kurs i lëndëve të formimit të specializues 1 | Menaxhim Shendetësor | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Ergonomi operatore | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| | Fotografi klinike dhe operatore | 1 | 25 | 20 | - | 5 |
| | Menaxhim i Informatikës së integruar | 3 | 75 | 30 | - | 45 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Materiale dentare dhe kirurgjikale | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| Metoda të kërkimit shkencor | Biostatistika | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Metodat e kërkimit shkencor | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| Kurs i inte gruar i mikrobiologisë dhe Semiotikës | Semiotikë kirurgjikale | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Mikorbiologji orale | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| Praktikë klinike 1 | Trajtim klinik i pacientit | 9 | - | - | 225 | - |
| Kurs i integruar i Patologjisë | Patologji orale 1 | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Patologji orale 2 | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Periodontologji | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Instrumente kirurgjike Implanto protetike | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Komponentë implanto Protetike | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| Gjithsej | | 60 | 1500 | 550 | 425 | 525 |

VITI II

| Lloji i veprimtarisë | Modulet | ECTS | Orë gjithsej | Orë në auditor | Orë praktike | Orë jashtë auditorit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Farmakologji | Farmakologji | 6 | 150 | 90 | - | 60 |
| Praktikë klinike 2 | Trajtimi klinik i pacientit | 10 | - | - | 250 | - |
| Kurs i integruar multidisiplinar | Anestezia dhe farmakologji | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Emergjenca kirurgjikale | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Radiologji diagnostikim imazhesh | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Patologji mjekësore e aplikuar | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Organizimi i modulit okluzal | 3 | 75 | 30 | - | 45 |
| | Proteza me vida dhe cementim | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| Sëmundje të brendshme | | 6 | 150 | 45 | - | 105 |
| Anatomi patologjike | | 6 | 150 | 45 | - | 105 |
| Praktikë klinike 2 | Trajtimi klinik i pacientit | 8 | - | - | 200 | - |
| Kurs i integruar i Kirurgjisë | Kirurgji e përgjithshme e aplikuar | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Kirurgji orale 1 | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Kirurgji ekzodontike komplekse | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| | Kirurgji orale 2 | 1 | 25 | 25 | - | - |
| | Terapi mjekësore | 1 | 25 | 10 | - | 15 |
| | Kirurgji OMF | 2 | 50 | 30 | - | 20 |
| Gjithsej | | 60 | 1500 | 515 | 450 | 535 |

Viti III

| Loji i Veprimtarisë | Modulet | ECTS | Ore gjithsej | Ore në audito r | Orë praktike | Orë jashtë auditorit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mjekësi ligjore | Mjekësi ligjore | 8 | 200 | 50 | 50 | 100 |
| Praktike klinike 3 | Trajtim klinik i pacientit | 10 | | | 250 | |
| Kurs i Integruar i Kirurgjise Orale te avancuar | Kirurgji ortognatike | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| | Kirurgji mukogingivale | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| | Kirurgji rigjenerative | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| Kurs i integruar i implantologjise | Implantologji 1; | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| | Implantologji 2 | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| | Proteza implantare | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| Principet e higjenes dentare dhe terapi kujdesi | Principet e higjenes dentare dhe terapi kujdesi | 4 | 100 | 30 | | 70 |
| Praktike klinike 3 | Trajtim klinik i pacientit | 10 | 250 | | 250 | |
| Kursi i Integruar i strumentariumit te kirurgjise orale | Strumente kirurgjikale te avancuara; (lazer dhe Piezosurgery) | 4 | 100 | 30 | | 70 |
| | Klinika odontostomatologjike | 2 | 50 | 30 | | 20 |
| Provimi perfundimtar | Provimi perfundimtar | 10 | | | | 250 |
| Gjithsej | | 60 | 1500 | 320 | 550 | 630 |

☑ Elementë të përgjithshëm të Programit të Studimit:

- Kohëzgjatja eshte 3 vite. Kjo kohëzgjatje është në përputhje me licencimin e këtij programi studimi. Por sic është theksuar edhe më lart, kjo kohëzgjatje nuk është në përputhje me standardet shtetërore përkatëse.
- Programi i SPA në Kirurgji përfshin afro 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas programit të paracaktuar.
- U konstatua që ngarkesa mësimore ndahej si më poshtë, ku afro:
    - 2% janë për lëndë të formimit bazë për specializantin,
    - 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese
    - 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja),
    - 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës,
    - 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe

- 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre ishin lëndë me zgjedhje).

U konstatua qe shifrat e mesiperme perputhen me standartet e programit te SPA ne Kirurgjine Orale

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit. Plani mësimor i këtij programi realizon standartin e kërkuar 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite
- Provimi (në çdo fund viti akademik).Ne fund te cdo viti akademik behej provim per lendet qe kishin zhvilluar gjate vitit. Provimi përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsistonte në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës.

☑ Prania e syllabuseve.

Elementët e syllabus-eve jepen ne Tabele (Tabela nr. 2). Elementet e syllabuseve jane te percaktura ne baze te standarteve ku jepet emertim i lendes, semestri, emri i pedagogut, cfare njohurish fiton studenti, temat teorike dhe praktike, ngarkesa ore ne auditor dhe jashte tij, metodat e mesimdhenies, format e vleresimit te studenteve, literatura baze dhe ndihmese.

Syllabus-et jepen për çdo lëndë, ku pasqyrohen te gjitha elementët

Tabela 2

| Elementet e Syllabuseve | Prania (PO/JO) |
|---|---|
| Emërtimi i lëndës/modulit | Po |
| Viti/semestri kur zhvillohet lënda | Po |
| Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën | Po |
| Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës | Po |
| Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë | Po |
| Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik | Po |
| Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS | Po |
| Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre | Po |
| Format e vlerësimit të studentëve | Po |
| Detyrimet e studentit për lëndën | Po |
| Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse | Po |

Syllabuset e lendëve që përfshihen në programin e specializimit afatgjatë në Kirurgji orale janë hartuar me elementët e parashikuara sipas standarteve të kërkuara

☑ Të dhëna për provimin përfundimtar/hartimin e tezës së SPA dhe mbrojtjen e saj. Jane bere ne baze te rregullores per specializimet afatgjata

☑ Të dhëna për provimin përfundimtar/hartimin e tezës së SPA dhe mbrojtjen e saj. Jane bere ne baze te rregullores per specializimet afatgjata

☑ Kontrolli i njohurive eshte bere nepermjet pjesmarrjes aktive, plotesimit te detyrimeve, detyra kursi, testime gjate vitit, provimi perfundimtar etj (Tabela 3).

Tabela 3

| Format e kontrollit | Pjesa ( në % ) ndaj totalit |
|---|---|
| Ndjekja e lendës dhe pjesëmarrja aktive | 10% |
| Plotësimi detyrimeve( laboratorike, detyra kursi | 10% |
| Testimi gjatë vitit | 20% |
| Provimi përfundimtar | 60% |
| Etj. | - |
| Në total | 100% |

Mendojme se programi i studimit per sa thame me siper afrohet me standartet shtetërore.

<u>**Vlerësimi sipas Standardeve**</u>

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **STANDARDI I - SYNIMET DHE QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT, KUADRI I PËRGJITHSHËM** | |
| **Standardi I. 1- Programet e studimeve specializuese afatgjata në mjekësi ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: misioni dhe qëllimi i tyre është shprehur qartë.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja e programeve të specializimeve afatgjata është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni ka një mision të qartë për programet e studimit që ofron.<br><br>**Kriteri 3** Qëllimi i programit të studimit dhe rezultatet që priten janë të qarta.<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionalë dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike.<br><br>**Kriteri 5** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve. | Programi I studimit " Specializim afatgjate ne Kirurgji Orale nuk eshte ne perputhje me titullin e programit ne License sepse atje e ka emrtimin SPA ne Kirurgji dhe jo Kirurgji Orale<br><br>Mendojme se programi e studimit ne Kirurgjine Orale te ofruar nga "Albanian University" eshte ne perputhje me qellimet e nje shkolle te larte e cila kerkon ti pergjigjet nevojave te tregut te punes, zhvillimit ekonomik te vendit si dhe plotesimit gjithnje e ne rritje te cilesise ndaj sherbimit te pacientit.<br><br>Nepermjet ketij program studimi mendojme se rriten aftesite intelektuale dhe profesionale te specializanteve nepermjet nje trajnimi cilesor.<br><br>Programi i studimit ne Kirurgjine Orale synon te pregatise kirurge duke ju pergjigjur kerkesave te tregut te punes ne kete fushe.<br><br>Mendojme se program ka objektiva te percaktuara qarte si per formimin teorik ashtu dhe praktik te specializantit<br><br>Mendojme se ky program eshte ne perputhje me kornizen shqipetare te kualifikimit. |
| **Standardi I. 2- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim | Mendojme se program i specializimit afatgjate ne |

| | |
|---|---|
| teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të aprovuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) pasi është marrë mendimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.<br><br>**Kriteri 2** Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës. | fushen e kirurgjise orale nepermjet persosjes se formimit teorik dhe praktik ne te ardhmen nepermjet nje Institucioni Shendetesor Ambulator i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, Ministria e Shendetesise si dhe marrja e mendimit te qendres kombetare te cilesise apo fale bashkepunimit me te tjere eshte i afte te pregatise specialiste te kesaj fushe<br><br>Mendojme se duhen permiresuar akoma me shume mesimdhenia dhe mesimnxenia duke futur teknologji te reja, duke motivuar kerkimin shkencor nepermjet bashkepunimit me institucione simotra brenda dhe jashte vendit. |
| **Standardi I. 3- Programet e studimeve janë eficente, në përputhje me misionin institucional.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni bën një planifikim institucional efikas dhe kryen përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve dhe rezulton se programi ka arritje të mira. | Ky program studimi eshte hartuar ne perputhje me qellimin dhe misionin e ketij universiteti |
| **Standardi I. 4- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe integrojnë kërkimin shkencor.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane. | Ky program eshte i hartuar duke ndjekur eksperiencen tone kombetare si dhe ate boterore |
| **Standardi I. 5- Programet e studimeve ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.<br><br>**Kriteri 2** Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj). | Programi i kirurgjise orale ne prespektive duhet pare i gershetuar me nevojat e tregut te punes te cilat mund te kufizohen.<br><br>Per sa i perket numrit te specializanteve qe duhen pranuar duhet rritur cilesia ne pranim nepermjet forcimit te kritereve |
| **Standardi I. 6- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Informacionet e ofruara nga institucioni mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshme për studentët si në formë të shkruar dhe elektronike.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni bën të njohur si në formë të shkruar dhe elektronike rregulloret e ndryshme të pranimit të studentëvë dhe të organizimit të programeve të studimit. | Per sa i perket informacionit te specializantit per programin e studimit, kohezgjatjes, ndarjen e oreve ne auditor dhe jashte tij, praktikat si dhe detyrimet qe lidhen me shlyerjen e lendes jane dhene qe ne fillim te vitit akademik si ne forme te shkruar ashtu dhe elektronike<br><br>Ne faqen e Webit te Albanian University si dhe ne te gjitha sekretarite mesimore jane publikuar rregulloret e pranimit te specializanteve si dhe organizimet perkatese te programeve |
| **Standardi I. 7- Përmbatja e programeve të studimeve është e plotë dhe e qartë në përmbushje të objektivave të këtyre programeve.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin me sukses të studimeve, | Programi i studimit jep njohuri specifike per |

| | |
|---|---|
| përfshirë këtu dhe kreditet (ECTS).<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike.<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të pikëve dhe notës minimale për përfundimin me sukses të lëndës/kursit.<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimeve përfshihen në një koncept të përbashkët, në një "plan diplomimi"[1]. | arritjen e nje kompetence profesionale ne zgjidhjen e nevojave te pacienteve per kete fushe gje e cila eshte pasqyruar nepermjet krediteve (ECTS).<br><br>Ky program ishte hartuar me profesioniste te vendit tone ne bashkepunim me eksperte Italian te Universitetit "La Sapienza" te Romes. Nepermjet programit shikohet se ka lende te pergjitheshme dhe ato te specialitetit si dhe praktika klinike. Mendojme se disa lende te programit aktual duhen zvogeluar apo zevendesuar me disa lende te tjera te cilat japin nje formim me kompleks te kirurgut oral<br><br>Per sa i perket vleresimit te studenteve ai ishte i arrire dhe siguron perfundimin me sukses te lendeve te kursit.<br><br>Plani i diplomimit ka konsistuar ne permbushjen e te gjithe detyrimeve akademike te specializantit. Ai ka siguruar frekuentimin, shlyrjen e prezencave si ne leksione, seminare apo praktika dhe promovimin e tyre me note kaluese. Provimi perfundimtar konsitonte ne prezantimin e nje Case Report te nje rasti klinik te trajtuar nga specializanti i cili dorezohet me shkrim dhe prezantohet me goje para komisionit qe ben vleresimin e provimit perfundimtar. Prezantimi i rasteve klinike eshte bere me power point duke dhene etapat e ndryshme klinike deri ne perfundimin me sukses te interventit. |
| **Standardi I. 8- Institucioni bën vlerësimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Vlerësimi i programeve të studimit bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumentave dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese, duke përfshirë gjithë proçesin në një sistem të informatizuar.<br><br>**Kriteri 3** Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.<br><br>**Kriteri 4** Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit. | Institucioni ka perdorur mekanizma formale per shqyrtimin miratimin dhe mbikqyrjen e herepashershme te programeve te studimit ne baze te rregulloreve perkatese, akteve te tjera normative dhe objektivave vjetore te Departamentit.<br><br>Metodat e vleresimit nga Institucioni kane qene te drejtperdrejta apo te terthorta.Vleresimi I drejtperdrejte eshte bere duke pare perqindjen e kalueshmerise si dhe analizen ne baze te plan programeve. Vleresimi i terthorte eshte bere ne varesi te vendimeve perkatese te keshillit te Universitetit, Fakulteteve apo Departameneteve.<br><br>Gjithashtu ishin ngritur grupe te perbera nga pedagoge, specializante, te cilet kane organizuar kontrolle te vazhdueshme apo nepermjet pyetsoreve perkates per kete problem. |

[1] "Plani i diplomimit" të studentit shpjegon kurrikulën, kurset që duhet të ndiqen për përfundimin e studimeve, mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.

| | |
|---|---|
| | Per rritjen e cilesise gjithashtu ka ndikuar edukimi ne vazhdim i stafit akademik te brendshem dhe te jashtem<br><br>Institucioni dispononte nje kodifikim dhe arkivim te te dhenave te nevojshme te aktivitetit mesimor dhe rezultateve te arritura si dhe synimet per te ardhmen.<br><br>U konstatua se programet e studimit permiresoheshin ne menyre te vazhdueshme ne baze te vleresimit te here pas hershem te tyre nga personeli akademik vendas dhe i huaj |
| **Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin në kohë të pedagogëve, tutorëve dhe strukturave të përfshira në rrjetin formues.<br><br>**Kriteri 3** Institucioni informon mbi rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme.<br><br>**Kriteri 4** Institucioni përdor metodologji që mundësojnë verifikimin dhe kontrollin e aplikimit sipas kritereve të programit formues të përcaktuar për çdo program specializues.<br><br>**Kriteri 5** Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente/metoda vlerësimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br>a. Ndjekje të studentëvë gjatë zhvillimit të praktikave dhe angazhimi i tyre në ndjekjen e rasteve klinike konkrete;<br>b. Vlerësimi me nota/pikë në fund të çdo viti;<br>c. Testime paraprake dhe dytësore: provime për module, praktikë;<br>d. Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;<br>e. Vlerësimi përfundimtar.<br>f. Të tërthorta<br>g. Sondazhet: të studentëve të rinj/të vjetër, të të diplomuarve;<br>h. Sondazhe të vlerësimit të kurrikulës (pjesës teorike dhe asaj praktike, kapaciteteve logjistike infrastrukturore dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.);<br>i. Intervista.<br><br>**Kriteri 6** Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura. | U konstatua se zyra e sigurimit te cilesise se programeve te studimit monitoronte realizimin e programeve per gjithe vitin akademik. Per kete vume re se organizoheshin takime me student dhe pedagoge<br><br>Per sa i perket performances se personelit akademik ne menyre periodike behej vleresimi i tyre nepermjet pyetsoreve drejtuar studenteve si dhe raportimeve te pergjegjesve te departamentit.Aktualisht keto realizoheshin me rruge elektronike.<br><br>Institucioni perdorte mekanizma formale per shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e here pas hershme te programeve te studimit te sanksionuara ne rregulloren perkatese.<br><br>Institucioni pas vleresimeve perkatese aplikonte politika qe siguronin rritjen e kesaj cilesie nepermjet vendimeve perkatese<br><br>Institucioni kishte kapacitete per arkivimin e te dhenave te nevojshme te aktiviteteve te ndryshme mesimore dhe rezultateve te arritura. Ky publikonte jo vetem rezultatet e arritura por dhe synimet ne te ardhmen |
| **Standardi I. 10- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH), me ligjin për profesionet e rregulluara në RSH si dhe me direktivat europiane mbi profesionet e rregulluara.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.<br><br>**Kriteri 2** Kohëzgjatja minimale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata nuk është më e vogël se ajo e përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtyre standardeve. | Specializanti grumbullonte ne perfundim te ciklit te specializimit 180 kredite duke bere 30 kredite cdo semester. Kjo eshte ne perputhje me ligjin per Arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise dhe urdherin e licensimit.<br><br>Kohezgjatja e programeve te studimit eshte brenda kritereve te percaktuara ne Urdherin e licensimit.<br><br>Por kohezgjatja e programeve te studimit dhe sasia e krediteve nuk eshte brenda kritereve te percaktuara nga shtojca 1 bashkengjitur standarteve te mesiperme. Ne kete shtojce SPA ne Kirurgji orale eshte percaktuar me kohezgjatje 4 vite -240 kredite. |
| **Standardi I. 11 - Hartimi dhe realizimi i programit të studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë bëhet sipas kritereve të parashikuara.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.<br><br>**Kriteri 2** Në studimet specializuese janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme në raport me ECTS-të totale minimale të parashikuara për programin specializues të paraqitur në shtojcën 1: 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje).<br><br>**Kriteri 3** Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 4** Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesorëve nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.<br><br>**Kriteri 5** Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës. Për këtë ngrihet një komision i përbërë nga 5 specialistë të fushës, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse, nga të cilët 2 të emëruar nga Ministri i | Programet e specializimieve respektonin rregulat e ndarjes se moduleve sipas specifikave te tyre. Rreth 80 % e ECTS ishin disiplinat e formimit te pergjithshem dhe karakterizues per specializimet perkatese dhe 20 % studime te organizuara teorike.<br><br>Ndarja e mesiperme qendronte per cdo karakter te specializimit: 2% per lende te formimit baze per specializantin, 2% per lende nderdisiplinore ose integrative, 1 % aktivitete te tjera (lende informatike, gjuhe te huaj ), 5% per provimin final, 30 % per lende karakterizuese te fushes ku ben pjese program specializues (nga te cilat 15 % e tyere duhet te jene lende me zgjedhje ) dhe 60 % per lende specifike te programit specializues (nga te cilat 15.5% e tyre jane lende me zgjedhje)<br><br>Plani i detajuar mesimor ishte miratuar sipas akteve nenligjore ne fuqi duke rrespektuar oret e shpenzuara te studentit ne auditor dhe ato te nevojshme jashte tij.<br><br>Ne perfundim te cdo semestri studentet veleresoheshin me note per provimet e caktuara te moduleve te kurrikules.<br><br>Provimi i formimit ishte provimi perfundimtar qe kurorezonte mbylljen e specializimit dhe kryhej para nje komisioni prej 5 anetaresh me mbrojtje te nje teme te paracaktuar dhe te punuara nga studenti<br><br>Studenti i nenshtrohej provimit perfundimtar ne perfundim te programit specializues i cili konsitonte ne testimin me goje prej nje kohe afersisht 30 minuta ku komisioni e veleresonte per formimin klinik diagnozen diferenciale, |

| | |
|---|---|
| Shëndetësisë, 1 nga Urdhri Profesional përkatës dhe 2 të emëruar nga fakulteti që ofron programin specializues. Kryetar i komisionit është një nga përfaqesuesit e emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:<br>a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike;<br>b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë;<br>c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë;<br>d. d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në rastë emergjente. | zgjidhjen e situatave te ndryshme klinike si dhe te emrgjences mjeksore. |
| **Standardi I. 13- Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë** | |
| **Kriteri 1** Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) për degën Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare "Master i Shkencave". Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk ka kriter për notën mesatare për t'u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në mjekësi. Lista e vendeve më sipër përcaktohet me udhëzim të përbashkët të MASH dhe MSH.<br><br>**Kriteri 2** Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.<br><br>**Kriteri 3** Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë duke vlerësuar notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 20% të pikëve totale, testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkuron për 40-50% të pikëve totale, intervistën me gojë për jo me shumë se 10-20% të pikëve totale duke përfshirë këtu, eventualiasht, dhe letrat e rekomandimit nga profesorë të fushës të cilët deklarojnë se kanë patur bashkëpunim shkencor me kandidatin. Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 minuta.<br><br>**Kriteri 4** Studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (e njohur në RSH). Në rastet kur nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga specializimi dhe shlyen financiarisht pagesat eventuale që ka përfituar gjatë specializimit.<br><br>**Kriteri 5** Këshilli i Profesorëve përcakton kriteret për t'u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik. Rregullorja e specializimit duhet të ketë marrë pëlqimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. | Studentet e pranuar ne kirurgjine orale vinin pasi kishin perfunduar programin e studimeve universitare te integruara cikli i dyte me kohezgjatje 5 vjecare (300 ECTS). Pranimi behej me vleresim me dosje.<br><br>Albanian University mundohej ti perzgjidhte me kujdes specializantet por jo me konkurs pranimi<br><br>Pranimi i studenteve ne programin e studimit ne AU ishte i hapur dhe ne te mund te regjistrohej kushdo qe plotesonte kushtet e percaktuara nga udhezimet dhe vendimet e MASH.<br><br>Kriter per pranimin e kandidatit ishte Licensimi.<br><br>Universiteti AU punonte dhe punon vazhdimisht per te permiresuar rregulloret e programeve te studimit te specializimeve afatgjata ne perputhje me ligjet dhe udhezimet e MAS dhe MSH.<br><br>Te gjithe specializantet qe konkuronin merrnin informacion per programin e studimit nga faqja e webit, sekretarite mesimore dhe UFO TV. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6** Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues, para se të pranohet në të. | |
| **Standardi I. 14 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.<br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. | Institucioni publikonte rregullisht ne bashkepunim me Albanian Press te gjithe informacionin ne forme broshurash, publikimesh apo materialesh mesimore si dhe perfshirjen e programeve te specializimit.<br>Faqja Online e Universitetit perditesohej dhe rifreskohej me informacione qe kane te bejne me organizimin e programit te studimit si dhe me elemente te vleresimit te brendshem |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Duke pare elementet e mesiperm mund te arrijme ne konkluzionin se:

1. Programi i studimit "SPA në Kirurgji" është zhvilluar në perputhje me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkences Nr.428 date 05/09/2011 per hapjen e programeve te studimit cikli i trete, studime specializuese afatgjata ne Fakultetin e Stomatologjise te Universitetit Privat "Albanian University", por termi "Kirurgji" nuk perputhet me standardet shtetërore për këtë program dhe emërtimi i saktë duhet të ishte *SPA në Kirurgji Orale.* Edhe kohëzgjatja e programit – 3 vite akademike (180 kredite) nuk përputhet me kohëzgjatjen dhe kreditet e përcaktuara në standardet shtetërore për SPA, përkatësisht 4 vite (240 kredite).
2. Programi i specializimit ka nderthurje te sakte midis lendeve teorike dhe praktike por mendoj se disa lende si: patologjia orale, fotografite klinike, materialet dentare, semiotika kirurgjikale, mikrobiologjia, histologji dhe embriologji duhet te hiqen ose te tkurren dhe te zevendesohen me lendet si biologjia klinike, anestezia e pergjitheshme dhe reanimacion, gjenetike, ORL dhe okluistike, Neurologji dhe Neurokirurgji, Farmakologji klinike, Hematologji dhe kardiologji, kirurgji plastike dhe terapi stomatologjike.
3. Programi i kirurgjise orale ne prespektive duhet pare i gershetuar me nevojat e tregut te punes dhe numri i specializanteve qe pranohen mund te kufizohet, duke rritur cilësinë ne pranim, nepermjet forcimit te kritereve.
4. Programi i hartuar nga specialiste vendas dhe te huaj mendoj se arrin nivelin e pregatitjes se kirurgeve oral me njohuri, aftesi dhe formim bashkekohor profesional.
5. Metodat e vleresimit te institucionin mendoj se jane te pershtateshme duke u persosur me shume ne te ardhmen.

## STANDARDI II - ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT ORIENTOHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

**Pjesa përshkrimore**

Fakulteti i Shkencave Mjeksore eshte nje strukture e re, e cila është krijuar nga riorganizimi institucional me Urdhër nr. 52, datë 05.02.2016. Por me emrin Fakultet i Stomatologjisë ka rreth 12 vite qe operon ne tregun e Arsimit te Larte Privat. Ky Fakultet si dhe Departamenti i Stomatologjise kishin rreth 4-5 vite qe po pregatisnin specialiste ne fushen e Kirurgjise Orale. Per arritjen e ketij qellimi ishte angazhuar personel akademik

efektiv (PAE), personel akademik me kontrate (PAK), dhe personel administrativ me nje raport jo te mire PAE/PAK.

**Tregues të matshëm:**

☑ Organigrama e Fakultetit

Mendojme se organigrama e fakultetit ishte ne perputhje me standartet shteterore. Gjate vizites sone u takuam me Rektoren Prof.Dr. Vera Ostreni, Zv Rektoren Aida Dama dhe per kurrikulumin Sidita Coniku.

☑ Keshilli i Profesorëve dhe Koordinatori i programit te studimit te ciklit te trete ne specializimet afatgjata ne Kirurgji Orale është ne baze te legjislacionit ne fuqi (Tabela 4).

Drejtues i programit te specializimit te Fakultetit te Shkencave Mjeksore ishte Prof. Dr. Akademik Anesti Kondili. Udheheqes i programit te specializimit te kirurgjise OMF ishte Prof.asoc. Livio Gallotini. Koordinatore e programit te specializimit ishte Dr.Shk.Med. Erda Qorri. Asistente te programit te specializimit ishin: Dr. Erlind Pepla, Dr. Anis Thodhoriani, Dr.Ina Zace.

Tabela 4

| Emër Mbiemër | Titulli | Pozicioni (anëtar/Kryetar) |
|---|---|---|
| Kaliopi Naska | Prof.Dr | Kryetar |
| Anesti Kondili | Prof.Dr | Anetar |
| Vera Ostreni | Prof.Dr | Anetar |
| Lida Miraj | Prof.Dr | Anetar |
| Fatmir Tartale | Prof.Dr | Anetar |
| Hivzi Muharremi | Prof.Dr | Anetar |
| Juliana Latifi | Prof.Dr | Anetar |
| Erda Qorri | Dr.Shk | Koordinatore e programeve te SPA |

Drejtues i programit te specializimit te Fakultetit te Shkencave Mjeksore ishte Prof.Dr. Akademik Anesti Kondili. Udheheqes i programit te specializimit te kirurgjise orale është Prof.asoc. Livio Gallotini, Koordinatore e programit te specializimit është Dr.Shk.Med.Erda Qorri, Asistente te programit te specializimit ishin: Dr.Erlind Pepla, Dr. Anis Thodhoriani, Dr.Ina Zace.

☑ Njësi kryesore/njësi bazë) të vetë institucionit që ofron SPA (Aneksi, Tabela 5)

Fakulteti i Shkencave Mjeksore kishte ne perberje tre njesi bazë:

- Departamenti i Stomatologjise
- Departamenti i Farmacise
- Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise

Dekane e Fakultetit te Shkencave Mjeksore është Dr.shk.Med. Erda Qorri. Pergjegjese e Departamentit te Stomatologjise është Dr.shk. Elona Kongo.

Personel Akademik Efektiv janë gjithesej 3, nga keto Prof. Dr. Vera Ostreni, Prof. Akademik Anesti Kondili, Dr.Shk. Erda Qorri. Kompetente per specializimin e Kirurgjise Orale.

Personel Akademik me kontrate ishin Prof.Asoc. Merita Bardhoshi dhe Prof.Asoc. Livio Gallotini, Msc Rugero Ingletto, Msc Maria Dezio.

☑ Strukturat me të cilat janë bërë marrëveshje.

Programi i specializimit eshte realizuar edhe me ndihmen e pedagogeve te ftuar me cikel leksionesh apo praktikash nga Universiteti La Sapienza si dhe Universiteti L'Aquilas Itali.

Gjithashtu ato disponpremium Kliniken Universitare te AU, si dhe kontrata me Sptalin e Durresit, Sptalin e Fierit, Spitalin e Traumes dhe QSUT Nene Tereza

Nga vizita ne institucion ne konstatuam se personeli akademik per programin e specializimit ne Kirurgjine Orale ne baze te dokumentacionit perkates afrohet me standartet shteterore, por mendojme se ky personel akademik duhet te kete me shume specialiste te Kirurgjise Orale me kompetence per te nxjerre Kirurge Oralë bashkekohore. Kjo duke pasur parasysh kerkesat aktuale te ligjit te ri te arsimit te larte.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **STANDARDI II- ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT ORIENTOHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT** | |
| **Standardi II. 1- Personeli akademik dhe administrativ organizohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.** | |
| **Kriteri 1** Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjikë për zhvillimin e institucionit. | Per sa i perket struktures akademike afrohej me standartet per te permbushur objektivat e ketij specializimi por mendojme se duhet rritur numri i profesionalistave me grade shkencore si vendas ashtu dhe te huaj. |
| **Standardi II. 2- Organizimi i institucionit është në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në përmbushje të misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete një nga të cilët ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programet e integruara të studimeve në fushën e Mjekësisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë.<br><br>**Kriteri 3** Fakulteti ose Qendra Kërkimore Shkencore janë të përbëra, së paku, nga 3 shërbime/departamente me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar. | Ne Departamentin e Stomatologjise gjate vizites sone ne konstatuam se ne sherbim te Programit te Specializimit te Kirurgjise Orale kishte vetem nje pedagog PAE kirurg oral me grade Doktor Shkencash. Personeli tjetër janë me tituj dhe grada shkencore, por jo në fushën e kirurgjisë orale.<br><br>Per sa thame me siper duhet te kete Profesor me titull ne fushen e Kirurgjise Orale me kohe te plote (PAE) i cili do te kontrolloje dhe monitoroje aftesimin e specializanteve te kesaj fushe. |
| **Standardi II. 3- Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të gjendjes financiare.** | |
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat dhe mbështetjet financiare të programit.<br><br>**Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja dhe kontratave të shërbimeve në lidhje me programin e studimit. | Gjate vizites per sa i perket transparences per te ardhurat dhe financimet e ndryshme bazuar ne tabelen 13 fq 107 sipas RVB na jepen keto te dhena deri ne vitin 2013. Nuk ka te dhena pas ketij viti. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:** | |

1. Per sa i perket struktures ne pergjithesi Universiteti Albanin University ka nje staf akademik te plote me tituj dhe grada shkencore si PAE, PAK, PA
2. Pasi analizuam me detaje permbushjen e Programit te Specializimit ne Kirurgjine Orale mendojme se Departamenti i Stomatologjise ka nje staf te kualifikuar, por jo te plote me grada dhe tituj shkencor si vendas ashtu dhe te huaj per te arritur mesimdhenien cilesore te standarteve Europiane aq me shume kur ka disa programe paralel te kesaj fushe.

## STANDARDI III - INSTITUCIONI DISPONON TË GJITHA KAPACITETET INFRASTRUKTURORE, TEKNOLOGJIKE DHE ORGANIZATIVE TË NEVOJSHME TË PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË

**Pjesa përshkrimore**

Ne konstatuam se Institucioni ky kryhet ky program specializimi eshte me vendodhje te perhershme ne Fakultetin e Shkencave Mjeksore Rruga e Durresit.

Per realizimin e programit praktik ishte ne dispozicion Klinika Universitare e cila ishte ne proces licensimi prane Ministrise se Shendetesise .

Gjithashtu aktiviteti klinik kryhej dhe me spitalet vendase apo te huaja me kohe te pjesshme

Ne institucion kishte disa salla konferencash te pajisura ne menyre te kenaqeshme, disa klasa ku organizohej mesimi me hapsirat e nevojshme dhe mjetet teknologjike perkatese.

Salla e biblotekes ishte e pajisur me literature profesionale kryesisht ne gjuhen italiane dhe angleze me burime te mjaftueshme per realizimin e ketij programi.Per sa i perket teksteve per specializantet ato ishin te mjaftueshem ne gjuhe te huaj por tekste shqip posacerisht per kete program ishin te pamjaftueshem ose mungonin.

**Tregues të matshëm:**

☑ Mjediset në funksion të programit SPA (Tabela 6)

Gjate vizites ne institucion ne konstatuam se egzistonin strukturat qendore thuajse te pershtatshme me standartet si dhe strukturat dytesore te mjaftueshme per realizimin e ketij programi.

Ajo qe mungonte ishte Spitali i Universitetit me Shtreter per te kryer Modulin e lendes se Kirurgjise Maksilofaciale. Per kete spital nuk na u dha asnje lloj dokumentacioni per fillimin e ndertimit te tij. Per sa i perket pjeses praktike te kirurgjise Maksilofaciale e cila eshte pjese perberese e programit te Kirurgjise Orale, pasi pyetem specializantet konstatuam se eshte kryer ne disa raste ne Itali, ne Spitalin e Fierit, te Durresit por ne QSUT dhe QUT (Ish Spitali Ushtarak) nuk gjetem dokumenta qe ta vertetojne nje gje te tille per realizimin e ketij moduli.

Tabela 6

| Mjediset dhe fasilitete për programin e SPA Për strukturat Dytësore | Sasia | Sipërfaqe $m^2$ |
|---|---|---|
| Salla për leksione | 6 | 607.2 |

| | | |
|---|---|---|
| Salla për seminare | 4 | 206.3 |
| Salla për aktivitete promovuese | 1 | 180 |
| Salla për praktikë lendore/ profesionale | 16 | 1295.6 |
| Laboratorë për lëndët | 5 | 182.6 |
| Laboratorë informatike | 0 | 0 |
| Salla interneti | 1 | 49 |
| Salla për bibliotekë | 1 | 17 |
| Mjedis për fotokopjime | 1 | 14.4 |
| Librari | 1 | 10 |
| Zyrë informacioni për studentët | 1 | 12 |
| Korridore/holle | 5 | 626.57 |
| Mjedise sportive | 0 | 0 |
| Mjedise për aktivitete të qeverisjes studentore | 0 | 0 |
| Mjedise clodhëse si kafeteri/fast-food/etj | 1 | 70 |
| Nyje higjeno-sanitare për studentët | 3 | 61.6 |

| Mjedise për stafin | Sasia | Spërfaqe m² |
|---|---|---|
| Zyra për dekanin/zv dekanin/kancelarin | 5 | 147.5 |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 8 | 184.54 |
| Zyra për departamentet/ qendrat e kërkimit | 7 | 125 |
| Zyra për përsonelin akademik | 13 | 325.2 |
| Zyrë e financës | 2 | 47 |
| Zyrë e NJSBC | 1 | 23.2 |
| Salla për mbledhje | 2 | 50.9 |
| Mjedise për stafin e shërbimi | 7 | 48.1 |
| Nyje higjeno sanitare për përsonelin akademik | 5 | 56.8 |
| Mjedise shërbimi për stafin | 8 | 145.14 |
| Mjeise shërbimi teknik | 5 | 89.16 |
| Zyra e burimeve njerëzore | 1 | 19 |

| Mjedise për Universitetin | Sasia | Sipërfaqe m² |
|---|---|---|
| Salla për bibliotekën e Universitetit | 3 | 297 |
| Zyra për strukturat e Rektoratit | 5 | 147.5 |
| Zyra për qendrat Kërkimore | 7 | 125 |
| Zyrë për financën | 2 | 47 |
| Zyrë për NJSBC | 1 | 23.2 |
| Mjedise fotokopjimi | 3 | 30 |
| Zyrë informacioni për studentët | 4 | 24 |
| Korridore/holle | 33 | 1857 |
| Mjedise sportive | 1 | 40 |
| Mjedis shërbimi me të tretët | 3 | 1130 |
| Nyje higjeno sanitare për studentët dhe 3 kafe | 22 | 223.4 |
| Zyra e burimeve njerëzore | 1 | 199 |

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **STANDARDI III - INSTITUCIONI DISPONON TË GJITHA KAPACITETET INFRASTRUKTURORE, TEKNOLOGJIKE DHE ORGANIZATIVE TË NEVOJSHME TË PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË** | |
| **Standardi III. 1- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve të studimit dhe në veçanti të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.<br><br>**Kriteri 2** Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.<br><br>**Kriteri 3** Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).<br><br>**Kriteri 4** Institucioni disponon struktura të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike dhe didaktike. Akreditimi i këtyre infrastrukurave kryhet nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore. Objekt i akreditimit janë strukturat përbërëse pjesë të rrjetit formues të njësisë që ofron programet e studimit specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë. Për struktura nënkuptohen strukturat fizike (departamentet, njësitë operative, shërbimet, qendrat, laboratorët, poliambulatorët, etj) pjesë e rrjetit formues ku zhvillohen aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për formimin e specializantëve.<br><br>Veçanërisht objekt i akreditimit janë strukturat qëndrore të njësisë që ofron programet e studimeve specializuese afatgjata, si ato të fakultetit apo universitetit. Këto struktura si dhe menaxhimi organizativ, administrativ, didaktik dhe teknik shëndetësor dhe aktivitetet e lidhura me to, koordinimi dhe/ose drejtimi i tyre për çdo njësi që ofron programe studimi specializimi, duhet të jenë të përshtatshme dhe strukturat të pajisura mjaftueshëm për organizimin dhe realizimin e aktivitetit formues profesional specializues në fushën e mjekësisë. Edhe në rastet kur mund të ekzistojnë më shumë se një strukturë e akredituar si struktura qëndrore/bazë, vetëm një prej tyre mund të konsiderohet si strukturë bazë efektive e njësisë që ofron programet specializuese afatgjata.<br><br>Objekt i akreditimit janë edhe strukturat dytësore të konvencionuara me strukturën qëndrore/bazë të cilat shërbejnë për të arritur ose kompletuar aktivitetin asistencial të kërkuar për formimin e specializantit, të cilat mund të jenë struktura universitare ose jo universitare, të të njëjtës strukturë spitalore ose jo. Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qendrore/bazë ose në strukturat dytësorë të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qendrore/bazë e dytësore.<br><br>**Kriteri 5** Akreditimi i strukturave të rrjetit formues bëhet pas verifikimit të plotësimit nga ana e IAL-së të standardeve të përshkruara në këtë dokument dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i jep të drejtën IAL-së që ofron programet | Gjate vizites ne konstatuam se Institucioni ky kryhet ky program specializimi eshte me vendodhje te perhershme ne Fakultetin e Shkencave Mjeksore, Rruga e Durresit.<br><br>Per realizimin e programit praktik ishte ne dispozicion Klinika Universitare e cila ishte ne proces licensimi prane Ministrise se Shendetesise .<br><br>Gjithashtu aktiviteti klinik kryhej dhe me spitalet vendase apo te huaja me kohe te pjesshme .<br><br>Gjithashtu konstatuam se Albanian University ka dorezuar formatin e aplikimit per licensim te Klinikes Universitare prane (Qendres Kombetare te Cilesise, Sigurise dhe Akreditimit te Institucioneve Shendetesore) |

<table>
<tr><td>specializuese të përdorë këto struktura për të organizuar e realizuar aktivitetin formues specializues për secilin specialitet. Strukturat e akredituara për një specialitet të caktuar mund të shtrijnë aktivitetin formues, me kërkesë të IAL-së, edhe në specialitete të tjera me kusht që të plotësojnë të gjitha standardet dhe kriteret e parashikuara për atë specialitet.<br><br>Kriteri 6 Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera në vend, të njohura/akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qëndrën Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, ose të huaja të akredituara për zhvillimin e programeve specializuese analoge në vendin përkatës, në bazë marrëveshjesh midis tyre.</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1 Strukturat qëndrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kritereve të mëposhtme dhe sipas kritereve specifike të parashikuara në shtojcën 2:<br><br>a. Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara;<br>b. Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara;<br>c. Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale;<br>d. Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike.<br><br>Kriteri 2 Të gjitha strukturat (psh. auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) plotësojnë standardet e përgjithshme.<br><br>Kriteri 3 Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:<br><br>a. për administratën dhe strukturat ndihmëse (sekretari didaktike, bibliotekë tradicionale dhe telematike, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët)<br>b. kompjuter në dispozicion të sekretarisë dhe administratës<br>c. program të kompjuterizuar për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë didaktike<br>d. faqe interneti të tijin<br>e. linja telefonike dhe pajisje për fotokopje<br>f. salla për leksionet dhe seminaret<br>g. laboratorë kërkimorë dhe didaktikë<br>h. kompjuter në dispozicion të studentëve të pajisur me lidhje interneti dhe akses në bazat e të dhënave profesionale on line (së paku 1 kompjuter / 5 studentë)<br>i. adresë poste elektronike personale për specializantët të ofruar nga struktura universitare<br>j. ambulatorë dhe struktura asistenciale (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit)<br>k. ambjente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2)<br><br>Ambjentet më sipër sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjenike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë</td><td>Per sa i perket infrastruktures mendojme se ka teknologjine e nevojshme per realizimin e mesimit dhe te kerkimit shkencor ne perputhje me standartet e ketij programi.<br><br>Ne pame disa salla konferencash te pajisura ne menyre te kenaqeshme, pame disa klasa ku organizohet mesimi me hapsirat e nevojshme dhe mjetet teknologjike perkatese.<br><br>Salla e biblotekes ishte e pajisur me literature profesionale kryesisht ne gjuhen italiane dhe angleze me burime te mjaftueshme per realizimin e ketij programi.Per sa i perket teksteve per specializantet ato ishin te mjaftueshem ne gjuhe te huaj por tekste shqip posacerisht per kete program ishin te pamjaftueshem ose mungonin.<br><br>Per sa i perket Klinikes Universitare ajo thuhet ne RVB faqe 46 se ka 100 vende pune, dhe pervec sallave te tjera ka dhe nje salle kirurgjie, por duke pare regjistrat e salles operatore numri i rasteve klinike te trajtuar ne kete klinike ishte i kufizuar per plotesimin e programit afatgjate ne Kirurgjine Orale.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.<br><br>**Kriteri 4** Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:<br><br>a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite.<br><br>b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qëndrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qëndrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.<br><br>**Kriteri 5** IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kritereve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë së 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.<br><br>**Kriteri 6** Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ komplesiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.<br><br>**Kriteri 7** Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin. | |
| **Standardi III. 3 - Rrjeti formues[2] plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.<br><br>**Kriteri 3** Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kritereve të mëposhtme:<br><br>a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme<br><br>b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional<br><br>c. Burime financiare të mjaftueshme<br><br>d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë<br><br>e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e | Per realizimin e aktivitetit praktik ne kirugjine orale sallat operatore ishin te plotesuar dhe plotesonin standartet perkatese per kryerjen e interventeve ne kushte sa me optimale<br><br>Per sa i perket institucioneve dytesore ishin ne perputhje me kerkesat standarte te ministrise nepermjet kartelave apo formes elektronike per te evidentuar dhe ruajtur punen e kryer gjithashtu ato mbaheshin ne regjistrat operatore te sallave kirurgjikale dhe librezat personale te studentave.<br><br>Gjate specializimit interventet kryheshin me dy apo tre specializante duke bere aspekte te vecanta te teknikes operatore per te |

[2] Me rrjet formues nënkuptohet bashkësia e të gjitha strukturave të përfshira në aktivitetet e parashikuara për secilin program specializues: strukturat qendrore/bazë, dytësore dhe komplementare.

| | |
|---|---|
| nevojshme profesionale<br>f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues<br>g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve<br>h. Efikasiteti dhe efiçenca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.<br>**Kriteri 4** Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë, dytësore, etj) dhe konvencionet eventuale me këto struktura dhe me ato komplementare.<br>**Kriteri 5** Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.<br>**Kriteri 6** Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.<br>**Kriteri 7** Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).<br>**Kriteri 8** Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specializantëve (sipas shtojcës 2).<br>**Kriteri 9** Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial komplesiv vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2). | plotesuar numrin e aktiviteteve te asistences ne perputhje me kriteret dhe standartet e formimit te tyre |
| **Standardi III. 4- Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon burime njerëzore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e programeve specializuese.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara.<br>**Kriteri 2** Çdo program specializues përcakton:<br>a. Një figurë drejtuese, përgjegjësi i programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.<br>b. Këshilli i profesorëve përveç përgjegjësit të programit të specializimit, përcakton një këshill drejtues të programit të studimit i cili, në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.<br>c. Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative.<br>d. d. Të paktën një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm. | Personeli akademik i angazhuar per realizimin e programit te specializimit nga specialistet vendas dhe te huaj ishin te dokumentuar ne zyren e burimeve njerezore.<br>Per sa i perket stafit te brendshëm (PAE) për programin e specializimit Kirurgji Orale i udhehequr nga Prof.Dr. Akademik Anesti Kondili mendojme se nuk eshte i plote, për arsye se nuk është profesor në fushën e specializimit |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Per sa i perket kapaciteteve infrastrukturore, teknologjike dhe organizative per realizimin e programit te specializimit afatgjate ne Kirurgjine Orale ne Albanian University ne konkluduam se :

1. Infrastruktura e ketij Universiteti permban klasa, te pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike per realizimin e ketij program ne baze te standarteve te kerkuara
2. Salla e biblotekes eshte e mjaftueshme dhe e pasur me literature profesionale ne gjuhen italiane dhe angleze por duhet pasuruar me literature profesionale ne gjuhen shqipe
3. Sallat e leksioneve jane te pajisura me projektor, internet dhe kapacitete te mjaftueshme per realzimin e ketij programi
4. Si strukturat baze ashtu dhe ato ndihmese jane te mjaftueshme por kerkohet ndertimi i spitalit te universitetit me shtreter si dhe shtimi i numrit te rasteve klinike ne kirurgjine orale
5. Shkolla ka librarine e saj, ku studentet mund te marrin literature perkatese per realizimin e programit
6. Per sa i perket stafit te plote te programit te specializimit i udhehequr nga Prof.Dr. Akademik Anesti Kondili mendojme se nuk eshte i plote, për arsye se nuk është profesor në fushën e specializimit.

## STANDARDI IV - PERSONELI AKADEMIK, SHËNDETËSOR, NDIHMËS MËSIMOR-SHKENCOR, ADMINISTRATIV DHE TUTORËT JANË TË MJAFTUESHËM DHE PLOTËSOJNË STANDARDET E PËRGJITHSHME SI DHE ATO SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR ÇDO SPECIALITET

**Pjesa përshkrimore**

Personeli akademik dhe administrativ u pa se njihte objektivat e programit te studimit dhe puna gjate programit bazohej mbi keto objektiva por nga profesoret e brendshem asnje nuk ishte i sektorit disiplinor te programit te specializimit te ofruar nga institucioni.

Gjithashtu ne konstatuam se dhe personeli ndihmes akademik si dhe mesimor,shkencor apo administrativ angazhohet ne realizimin e ketij program studimi

Personeli akademik i brendshem ishte i mjaftueshem per realizimin e ketij programi si dhe me gradat apo titujt perkates.

U konstatua se proceduart ligjore per rekrutimin e personelit kryheshin ne baze te standarteve shteterore.

Per sa i perket tutoreve ne konstatuam se jo te gjithe kishin eksperience 10 vjecare ne sferen e kirurgjise orale dhe aq me teper graden shkencore doktor ne kete fushe gje qe nuk perputhet me standartet aktuale te ketij programi.

Stafi i mësimdhënies përbëhej nga pedagogë shqiptarë për të cilët kishte kontrata pune të lidhura me Institucionin,por kishte dhe pedagogë të huaj italianë të aktivizuar në procesin mësimor në bazë të një marëveshje të lidhur nga një përfaqësues i shoqërisë "UFO" dhe shoqërisë Dental Training Services Corporation (T.A.S.C).

**Tregues të matshëm:**

☑ Numri i personelit akademik, i përfshirë në programin e specializimit afatgjatë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (shih Aneks Tabela 7)

Tabela 7

| Titulli | Programi i Studimit në Kirurgji | | |
|---|---|---|---|
| | PAE Femra | PAE Meshkuj | Raporti M/F |
| Akademik | | 1 | |
| Profesorë | 1 | | 1/0 |
| Profesorë të As. | | - | 0/1 |
| Doktorë | 1 | 4 | 4/1 |
| Doktor në proc | - | - | |
| Personeli Administrativ | 2 | 1 | 2/1 |

☑ Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për Programin e Specializimeve (Tabela 8)

Tabelat 8

Personel i brendshëm (efektiv)

| Nr. | Emri mbiemri | Detyra në Departament | Titulli / Grada |
|---|---|---|---|
| 1 | Vera Ostreni | Rektore e Institucionit | Prof.Asc |
| 2 | Anesti Kondili | Zv/ rektor | Pro. Dr. Akademik |
| 3 | Erda Qorri | Kordinatore e Specializimeve | Dr. Shken. Med. |
| 4 | Gaetano Marenzi | Kirurg oral | Dr. Shken. Med. |
| 5 | Mauro Mariniello | Dermatolog, Sëmundje infektive | Dr. Shken. Med. |
| 6 | Tomasso Bocchetti | Implantolog | Dr. Shken. Med. |
| 7 | Mariani Tia | Protetika Dentare | Dr. Shken. Med. |

Personel akademik me kontratë (jo efektiv)

| Nr | Emri mbiemri | Titulli / Grada | Institucioni ku punon me kohë të plotë |
|---|---|---|---|
| 1 | Nikollaq Leka | Prof. Asc | Q.S.U.T. Departamenti i Anatomisë |
| 2 | Sofika Qemirami | Prof. Dr. | Q.S.U.T. Departamenti i Anatomisë |
| 3 | Maria Dezio | Msc. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 4 | Ruggeto Ingleto | Msc. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 5 | Valeria Savoia | Msc. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 6 | Kostandinos Besharat | Phd | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 7 | Eduart Harshova | Prof. Asc | Q.S.U.T. |
| 8 | Arben Gjata | Prof. Dr. | Q.S.U.T., Kirurg |
| 9 | Florika Mandro | Prof. Dr. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 10 | Simone Stafoli | Dr. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 11 | Najada Como | Prof. Asc | Q.S.U.T. |
| 12 | Mehdi Alimehmeti | Prof. Dr. | Q.S.U.T. |
| 13 | Bardhyl Cipi | Prof. Asc. | Q.S.U.T. |
| 14 | Roberto Minassi | Dr. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 15 | Paolo Arduini | Dr. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 16 | Giovani Fallisi | Dr. | Universiteti " La Sapienza" Romë |
| 17 | Merita Bardhoshi | Prof. Asc. | FMD |
| 18 | Dariel Tehreska | Dr. | Q.S.U.T. Kirurg |
| 19 | Livio Gallottini | Prof. Asc. | Universiteti " La Sapienza" Romë |

☑ Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 9)

Tabela 9

**Shpërdarja e ngarkesës mësimore e stafit akademik (2014-2015)**

| Nr. | Emri i pedagogut/pedagoges | Sasi e orëve |
|---|---|---|

| Lënda /Moduli | Pedagogu/Pedagogët | Titulli/grada Kualifikimi | Departamenti përgjegjës | PAE apo PAK |
|---|---|---|---|---|
| Kurs i Lëndëve të Formimit të Përgjithshëm 1 | Nikollaq Leka<br>Sofika Qamirani<br>Vera Ostreni<br>Anesti Kondili | Prof.Asoc.<br>Prof.Dr.<br>Prof.Asoc.<br>Prof.Dr.Akademik | | PAK<br>PAK<br>PAE<br>PAE |
| Praktikë Klinike 1 | Erda Qorri | Dr.Shk.Med. | | PAE |
| Kurs i Lëndëve të Formimit të Specializues 1 | Maria Dezio<br>Ruggero Ingletto<br>Valeri Savoia<br>Kostandinos Besharat<br>Gaetano Marenzi<br>Tommasso Bocchetti | Msc<br>Msc.<br>Msc<br>Dr.Shk Med<br>Dr<br>Dr | | PAK<br>PAK<br>PAK<br>PAK<br>PAE<br>PAE |
| Metodat e Kërkimit Shkencor | Eduart Hashorva | Prof.As | | PAK |
| Kurs i Integruar i Mikrobiologjisë dhe Semiotikës Kirurgjikale | Medi Agolli<br>Valeria Savoia<br>Gaetano Marenzi | Prof.Dr.<br>Msc.<br>Dr. | | PAK<br>PAK<br>PAE |
| Kurs i Integruar i Patologjisë | Tommasso Bocchetti<br>Mariano Tia | Dr.<br>Dr. | | PAE<br>PAE |
| Farmakologji | Florika Mandro | Prof.Dr | | PAK |
| Praktikë Klinike 2 | Simone Stafoli<br>Erda Qorri | Proc.Dr.<br>Dr.Shk.Med. | | PAK<br>PAE |
| Kurs i Integruar i Trajtimit Multidisiplinar | Livio Gallottini<br>Mariano Tia | Prof.As<br>Dr. | | PAK<br>PAE |
| Sëmundje të Brendshme | Najada Como<br>Mauro Mariniello | Prof.As.<br>Dr.Shk.Med. | | PAK<br>PAE |
| Anatomi Patologjike | Mehdi Alimehmeti | Prof.Dr | | PAK |
| Kurs i Integruar i Kirurgjisë | Rugero Ingletto<br>Gaetano Marenzi<br>Erda Qorri<br>Mariano Tia | Msc<br>Dr.<br>Dr.Shk.Med<br>Dr. | | PAK<br>PAE<br>PAE<br>PAE |
| Mjekësi Ligjore | Bardhyl Cipi | Prof. Dr | | PAK |
| Praktikë klinike 3 | Roberto Minassi<br>Erda Qorri<br>Merita Bardhoshi | Dr.Shk.Med.<br>Dr.Shk.Med.<br>Prof.As. | | PAK<br>PAE<br>PAK |
| Kurs i Integruar i Kirurgjisë Orale të Avancuar | Paolo Arduini<br>Gaetano Marenzi<br>Tommasso Bocchetti | Dr.Shk.Med.<br>Dr.Shk.Med.<br>Dr. | | PAK<br>PAE<br>PAE |
| Kurs i Integruar i Implantologjisë | Giovani Fallisi<br>Tommaso Bocchetti | Dr.Shk.Med<br>Dr. | | PAK<br>PAE |
| Principet e Higjienës Dentare dhe Terapi Kujdesi | Mariano Tia | Dr. | | PAE |
| Kurs i Integruar i Instrumentariumit të Kirurgjisë Orale | Giovani Barbini<br>Erda Qorri<br>Merita Bardhoshi | Dr.<br>Dr.Shk.Med.<br>Prof.As | | PAK<br>PAE<br>PAK |
| Provimi Përfundimtar | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Nikolaq Leka | 37.5 |
| 2 | Sofika Qemirani | 37.5 |
| 3 | Vera Ostreni | 55 |
| 4 | Anesti Kondili | 37.5 |
| 5 | Erda Qorri | 735 |
| 6 | Mario Dezio | 32.5 |
| 7 | Rugerro Ingleto | 32.5 |
| 8 | Valeria Savoia | 52.5 |
| 9 | Kostandinos Besharat | 22.5 |
| 10 | Livio Gallattini | 37.5 |
| 11 | Eduart Harshova | 75 |
| 12 | Arben Gjata | 15 |
| 13 | Flora Mandro | 97.5 |
| 14 | Simone Stafoli | 25 |
| 15 | Naiada Como | 22.5 |
| 16 | Bardhyl Cini | 82.5 |
| 17 | Roberto Minassi | 12.5 |
| 18 | Mehdi Alimehmeti | 52.5 |
| 19 | Paolo Arduini | 22.5 |
| 20 | Giovani Fallisi | 15 |
| 21 | Muro Marinello | 30 |
| 22 | Tomasso Bocchhetti | 397.5 |
| 23 | Mariano Tio | 285 |
| 24 | Merita Bardhoshi | 12.5 |
| 25 | Dariel Thereska | 10 |

☑ Të dhëna sipas moshës për PAE (Tabela 10)

Tabela 10

| **Personeli sipas titujve/grada** | **25-35** | **36-45** | **46-55** | **56-65** | **66-68** |
|---|---|---|---|---|---|
| Porfesorë | | | | | 1 |
| Profesor i Asociuar | | | 1 | 1 | |
| Doktorë | 1 | 3 | | | |
| Doktorë në proces | | | | | |
| Pedagogë ( pa tituj) | 2 | 1 | | | |

☑ Të dhëna sipas moshës për PAK

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (25-35) | (36-45) | (46-55) | (56-65) | (66-68) |
| Profesorë | | | 2 | | 4 |
| As. Prof | | | 3 | | 1 |
| Doktorë | 2 | 2 | | 1 | |
| Doktor në proces | 1 | 1 | | | |
| Pedagogë (pa tituj) | 2 | | | | |

☑ Të dhënat sipas gjinisë

| **Titulli** | **Programi i studimit** | | |
|---|---|---|---|
| | PAE Femra | PAE meshkuj | Raporti M/F |
| Profesorë | - | 1 | 0/1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Profesorë të Asociuar | 1 | - | 1/0 |
| Doktorë | 1 | 4 | 1/4 |
| Doktorë në proces | - | - | - |
| Administratë | - | - | - |

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjate vizites sone ne institucion pame se numri i personelit akademik efektiv dhe me kontrate ishte ne perputhje me standartet akademike

**Vlerësimi sipas Standardeve**

<table>
<tr><th>Standardi/Kriteret</th><th>Vlerësimi sipas standardeve</th></tr>
<tr><td colspan="2">STANDARDI IV - PERSONELI AKADEMIK, SHËNDETËSOR, NDIHMËS MËSIMOR-SHKENCOR, ADMINISTRATIV DHE TUTORËT JANË TË MJAFTUESHËM DHE PLOTËSOJNË STANDARDET E PËRGJITHSHME SI DHE ATO SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR ÇDO SPECIALITET</td></tr>
<tr><td colspan="2">Standardi IV. 1 - Personeli i angazhuar në programet specializuese plotëson standardet e parashikuara</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues.<br><br>Kriteri 2 Institucioni disponon personel akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas specifikimeve në shtojcën 2.<br>a. Pedagogë universitarë: profesorë, profesorë të asociuar dhe docentë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm është nga sektori disiplinor i programit të specializimit që ofrohet nga institucioni.<br>b. Pedagogë jo universitarë që ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues: personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve dhe me të cilët është lidhur një kontratë me kohëzgjatje të paktën sa kohëzgjatja e secilit program specializues.<br>c. Pedagogë të jashtëm me kontratë: ekspertë të sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.<br><br>Kriteri 3 Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këto programe përbën një garanci për realizimin e programeve (50% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, të angazhuar në punën klinike dhe me tituj akademikë: "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose gradë shkencore "Doktor" apo "PHD" të fituar në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.<br><br>Kriteri 4 Numri i studentëve që mund të ndiqet nga një tutor është jo më i madh se 3 (tre).</td><td>Personeli akademik dhe administrativ u pa se njihte objektivat e programit te studimit dhe puna gjate programit bazohej mbi keto objektiva por nga profesoret e brendshem asnje nuk ishte i sektorit disiplinor te programit te specializimit te ofruar nga institucioni.<br><br>Per sa i perket performances ajo kontrollohej nga zyra e sigurimit te brendshem te cilesise e cila angazhohej se bente here pas here rekomandimet e nevojshme per te permiresuar keto objektiva ne baze te standarteve te kerkuara.<br><br>Gjithashtu ne konstatuam se dhe personeli ndihmes akademik si dhe mesimor,shkencor apo administrativ angazhohet ne realizimin e ketij program studimi ne menyre qe te afrohet me standartet e kerkuara .<br><br>Personeli akademik i brendshem ishte i mjaftueshem per realizimin e ketij programi si dhe me gradat apo titujt perkates.<br><br>Per sa i perket tutoreve ato drejtonin me shume se tre studente ne programin e specializimit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Standardi IV. 2 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe</td><td>U konstatua se proceduart ligjore per rekrutimin e personelit kryheshin ne baze te</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit dhe detyrave që u janë caktuar.<br><br>**Kriteri 3** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. | standarteve shteterore.<br><br>Per vleresimin e cilesise se veprimtarise mesimore dhe kerkimoro shkencore te pedagogeve kjo behej ne baze te vleresimit te drejtuesve te departamentit, vleresimit te specializanteve dhe vleresimit nga njesia e brendeshme e sigurimit te cilesise<br><br>Specializantet plotesonin online pyetsore per vleresimin e pedagogeve dhe asistenteve me te cilet ato bashkepunojne,pastaj keto u jepen pedagogeve dhe drejtuesi i deprtamentit ben verejtje dhe le detyrat per permiresimin e situates ne te ardhmen .<br><br>Per sa i perket dokumentacionin te rekrutimit te personelit ato na u paraqiten ne drejtorine e burimeve njerezore te cilat ishin te arkivuara dhe te ruajtura me kujdes. |
| **Standardi IV. 3- Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni, që ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka kryer së paku pesë vjet studime në një institucion të huaj në të njëjtën gjuhë mësimdhënieje, ose disponon një çertifikatë për njohje të avancuar të gjuhës së mësimdhënies të njohur ndërkombëtarisht në nivelin C1, dhe ka kryer së paku një vit studime në një institucion me të njëjtën gjuhë mësimdhënieje,.<br><br>**Kriteri 3** Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka mbajtur mbi 10 kumtesa shkencore në këtë gjuhë. | Ne konstatuam se personeli akademik vendas angazhohet ne mesimdhenie ne gjuhen shqipe ndersa mjaft lektore te ftuar kryesisht ne gjuhen italiane jane angazhuar ne dhenien e mesimit per specializantet e kirurgjise orale ne kete gjuhe.<br><br>Nga pedagoget e brendshem vetem njeri ka fituar graden doktor shkencash jashte vendit. |
| **Standardi IV. 4- Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.** | |
| **Kriteri 1** Studenti ka një udhëheqes klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka gradën "Doktor".<br><br>**Kriteri 2** Studentit që ka një udhëheqës klinik që nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet dhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik të institucionit me së paku gradën shkencore "Doktor" apo "PhD" (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.<br><br>**Kriteri 3** Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.<br><br>**Kriteri 4** Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin | Per sa i perket tutoreve ne konstatuam se jo te gjithe kishin eksperience 10 vjecare ne sferen e kirurgjise orale dhe aq me teper graden shkencore ne kete fushe, gje qe nuk perputhet me standartet aktuale te ketij programi.<br><br>Tutoret ishin te punuesuar me kohe te plote dhe me kontrate me institucionin qe ofron programin specializues.<br><br>Udheheqesit klinik u pa se ishin pergjegjes per drejtimin e specializanteve gjate punes se tyre me paciente dhe kishin kohen e mjaftueshme per te mbikqyrur specializantet. |

| | |
|---|---|
| specializues.<br><br>**Kriteri 5** Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.<br><br>**Kriteri 6** Udhëheqësi klinik i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës klinike të studentit.<br><br>**Kriteri 7** Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.<br><br>**Kriteri 8** Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.<br><br>**Kriteri 9** Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.<br><br>**Kriteri 10** Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.<br><br>**Kriteri 11** Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin. | |
| **Standardi IV. 5- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. | Gjate vizites konstatuar se Albanian University disponon listen e plote te personelit akademik efektiv dhe me kontrate, te personelit ndihmes mesimoro shkencor dhe personelit administrativ qe angazhohet per realizimin e programit. |
| **Standardi IV. 6- Institucioni angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizon programe të zhvillimit profesional të mëtejshëm të personelit akademik të angazhuar në program e të personelit mbështetës.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash të programeve të kualifikimit. | "AU" organizonte programe kualifikimi profesional per personelin akademik drejtuar nga profesioniste me tituj shkencore kryesisht mbi kurrikulat, kompetencat, vleresimin e studenteve dhe procesin e akdreditimit .<br><br>Mendojme se keto programe kualifikimi kane ndikuar ne persosjen me tej te mesimdhenies, hartimin e programeve te lendeve, per njohjen e zhvillimit te arsimit te larte, bazuar kjo dhe ne qendra te tjera te zhvillimit dhe te kerkimeve.<br><br>Programet e kualifkimit ishin ne hardcopy dhe ne rruge elektronike, gjithashtu mendojme se UFO TV luan nje rol te rendesishem ne kujtesen e veprimtarive formuese kualifikuese |
| **Standardi IV. 7- Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me veprimatrinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të përfshirë në këtë veprimtari, në rast se ka, edhe të mbështetjes financiare të institucionit ndaj tyre.<br><br>**Kriteri 2** Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit. | U pa se per sa i perket kualifikimit dhe aktiviteteve shkencore te stafit akademik mbeshtetur dhe nga Albanian University ato disponoheshin ne baze te dhenash te cilat nga drejtuesit e departamenteve kerkoheshin here pas here per plotesimin e tyre.Gjithashtu kjo shtrihej dhe per sa i perket botimeve brenda apo jashte vendit te personelit akademik te angazhuar ne kete program |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Pasi u be vleresimi per sa i perket udheheqesve me grada dhe tituj shkencore, nuk ka asnje profesor te brendshem ekspert i fushes se kirurgjise orale qe te ndihmoje specializantet per tju permbajtur kritereve ne realizimin e plote te ketij programi.
2. Vleresimi i personelit akademik behej ne baze te standarteve shteterore
3. Per sa i perket tutoreve ato jo te gjithe ishin me eksperience mbi 10 vjecare ne fushen e kirurgjise orale
4. Tutorët e specializantëve drejtonin me shume se tre studente ne programin e specializimit

## STANDARDI V - STUDENTËT

### Pjesa përshkrimore

Pranimi behej me dosje dhe me nje interviste per te vleresuar njohurite dhe njohese komunikative dhe operative te aplikantit.

U konstatua se per pranimin e specializanteve nuk kishte konkurs dhe provim pranimi por ne baze te nje formulari te plotesuar nga aplikanti dhe te kritereve te vendosura nga IAL

Gjatë vizitës në ne sekretarine mesimore konstatuam se ajo dispononte statistikat vjetore te specializanteve ne vazhdimesi deri ne diplomimin e tyre me perjashtim te dy-tre rasteve qe kishin bere levizje prane programeve te tjera te ketij Fakulteti

### Tregues të matshëm:

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit te studentave beheshin me dosje dhe pa konkurs. Studenti paraqit në dosje: Diplomën e shkollës paraardhëse, Listën e notave, Fotokopje të kartës së identitetit, Formularin e aplikimit.

☑ Kushte specifike të pranimit të studentëve

Numri i studentëve duke pare tregun e punes ishte i madh, por mundesite per specializim nga institucioni egzistonin.

☑ Të dhëna statistikore për studentët e pranuar:

- Numri total i studentëve specializantë të regjistruar dhe numri tyre për çdo vit, brezi i pare (2012-2015) kishte 12 studente, ndersa brezi i dyte (2014-2017) kishte 11 studente.
- Numri i specializantëve të regjistruar që vijnë nga jashtë njësisë që ka hapur programin e studimeve të SPA, nuk kishte te transferuar.
- Numri i diplomave të lëshuara për marrjen e diplomës së specializimit për çdo vit.Studentet nuk ishin pajisur me diploma.
- Kohëzgjatja mesatare e studimeve të SPA dhe cila ka qenë tendenca e këtij treguesi.Kohezgjatja e specializimit te kirurgjise orale ishte 3 vjecare. Nese bashkohet me implantologjine mund te behet 4 vjecare.
- Numri dhe përqindja që zë, në nivel programi studimesh, i atyre që kanë ndërprerë studimet e SPA. Nuk ka patur studente qe kane nderprere studimet.
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare.U konstatua se kishte 2 specialiozante nga Kosova
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga rajoni i Ballkanit;U konstatua se 18 % e specializanteve ishion nga Ballkani
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vendet e BE-së; Nga vendet e BE nuk ka asnje te regjistruar
- Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vende të tjera të botës; Nga vendet e tjera te botes nuk kishte asnje te regjistruar

☑ Të dhëna për mobilitetin e studentëve specializantë në Universitetet jashtë vendit

U konstatua se nje pjese e specializanteve kryenin aspekte te pjesshme specializimi ne Itali.

☑ Të dhëna për vlerësimin përfundimtar të studentëve në SPA

Vleresimi perfundimtar i specializanteve behej ne baze te standarteve shteterore

☑ Të dhëna për strukturat dytësore brënda ose jashtë vendit, ku studentët kanë kryer aktivitetet asistenciale (ose kërkimet e tyre shkencore):

Per sa i perket spitaleve brenda vendit nga te dhenat e specializanteve konstatuam se ishte shfrytezuar spitali rajonal i Fierit dhe i Durresit ndersa per sai perket spitaleve jashte vendit ai i Ankones ne Itali, me kontrata zyrtare

☑ Të dhëna për:

- Botimet/referimet e studentëve ;
- Revistat, entet botuese ku janë botuar këto artikuj

Disa specializante ishin angazhuar ne prezantime apo botime ne revista brenda dhe jashte vendit,ne konferencat e organizuara nga Albanian University. Ne konstatuam se nga viti 2012 -2016 jane organizuar 5 konferenca shkencore, nga keto nje eshte organizuar per specializantet. Botimet jane ne revisten Stomatologjike Shqiptare dhe te Kirurgjise OMF dhe ne UFO Press.

Ne faqen 116 te RVB tabela 16 te dhena per kerkim shkencor jepen projekte shkencore ne rang departamenti 100 studentë, por nuk specifikohen specializantet. Po keshtu dhe në tabelen numer 17. Gjithashtu dhe ne faqen 19 te RVB tabela nr 18 jepen aktivitete shkencore ne rang institucioni por nuk specifikohen ato që janë zhvilluar per specializantet.

☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. (Tabela 11)

Tabela 11

| **Aktiviteti shkencor i IAL** | **Numri i studentëve të aktivizuar** |
|---|---|
| Për punime shkencore individuale të pedagogëve | Nga të dhënat e siguruara në Institucion rezulton se janë zhvilluar: 1 konferencë ndërkombëtare, rreth 5 konferenca shkencore në nivel departamenti, 5 konferenca me studentët, dhe 1 open day me studentë dhe specializantë |
| Për projekte shkencore në rang Fakulteti/ Departamenti/ programi SPA | N/A |
| Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë | N/A |

Megjithatë të dhënat tabelore në rang Universiteti janë vendosur në Aneksin 1, në Tabelat 12, 13, 14 dhe 15.

Nga specializantet ka nje numer te caktuar punimesh shkencore me pedagoget apo bashkepunimi me te tjere te peraferta me standartet e kerkuara

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **STANDARDI V - STUDENTËT** | |
| **Standardi V. 1- Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.** | |
| **Kriteri 1** Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë specializimi dhe i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive te aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).<br><br>**Kriteri 3** Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.<br><br>**Kriteri 4** Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe | U konstatua se per pranimin e specializanteve nuk kishte konkurs dhe provim pranimi por ne baze te nje formulari te plotesuar nga aplikanti dhe te kritereve te vendosura<br><br>Pranimi behet me dosje dhe me nje interviste per te vleresuar njohurite dhe njohese komunikative dhe operative te aplikantit. |

| | |
|---|---|
| harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit. | |
| **Standardi V. 2- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.<br>**Kriteri 2** Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.). | U pa se institucioni ne sekretarine mesimore dispon採onte statistikat vjetore te specializanteve ne vazhdimesi deri ne diplomimin e tyre me perjashtim ted y tre rasteve qe kishin bere levizje prane programeve te tjera te ketij Fakulteti<br>Pranimi ne programin e studimit te specializimit afatgjate ne kirurgji orale behej konform ligjit te arsimit te larte te Republikes se Shqiperise dhe aktet nenligjore ne fuqi. |
| **Standardi V. 3- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.<br>**Kriteri 2** Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit. Ato publikohen në ambientet e fakultetit. | U konstatua se kriteret e pranimit dhe vazhdimesia e programit te studimit vleresohej ne menyre te vazhdueshme ne baze te zhvillimeve dhe ndryshimeve qe ndodhin ne sistemin arsimor ne Republiken e Shqiperise per te cilat informohen here pas here specializantet per ndryshimet perkatese<br>Per sa i perket vleresimit te specializantit ato ishin transparente dhe publikoheshin ne ambjentet e Fakultetit pa vonesa ne dhenien e tyre. |
| **Standardi V. 4 - Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.<br>**Kriteri 2** Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:<br>a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj.;<br>b. Punën e pavarur në laborator/klinikë;<br>c. Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit;<br>d. Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike;<br>e. Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe | Per ecurine e veprimtarise mesimore dhe kerkimore te specializantit merrej stafi akademik dhe ai mbeshtetes ku here pas here organizonte takime individuale dhe ne grup per permiresimin e problemeve qe dilnin gjate procesit.<br>Programi I specializimit arrihej nepermjet aktiviteteve teorike, aktiviteteve klinike dhe organizimit te aktiviteteve shkencore.<br>Asimilimi I programit behej kryesisht ne gjuhen shqipe pa perjashtuar dhe gjuhen angleze dhe italiane.<br>U pa se specializantet ishin jo vetem pjesmarres por dhe debutues me prezantimet e tyre jo vetem ne shqiperi por dhe ne itali. |

| | |
|---|---|
| përpunimit të të dhënave;<br>f. Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit.<br>**Kriteri 3** Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike.<br>Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:<br>a. Ligjërata;<br>b. Seminare;<br>c. Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve;<br>d. Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik.<br>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.<br>**Kriteri 4** Studenti fiton aftësi[3] për komunikimin e duhur me nivel profesional<br>**Kriteri 5** Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët. | Gjithashtu specializantet prezantojne provimin e tyre perfundimtar me nje case report te shkruar ne power point.<br>Keto njohuri I siguronin specializantit nje aftesi jo vetem per te permbushur programin e specializimit por dhe per te vazhduar me tutje me programin e studimit doctoral.<br>Ne fund te specializimit mendojme se specializantet ishin pajisur me njohuri dhe aftesi te mira komunikimi profesional dhe human. Kete e perforcojne me shume lende te tilla si biostatistika, metodat e kerkimit shkencor etj.<br>Sipas rregullores se percaktuar nga shkolla e specializimeve mendojme se studentet I kane permbushur kerkesat e etikes profesionale |
| **Standardi V. 5 - Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.** | |
| **Kriteri 1** Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.<br>**Kriteri 2** Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.<br>**Kriteri 3** Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.<br>**Kriteri 4** Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.<br>**Kriteri 5** Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.<br>**Kriteri 6** Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj. | Programi I studimit ne Kirurgjine Orale mendojme se zhvillohej ne kushte infrastrukturore dhe me nje klinike duke ndihmuar formimin akademik dhe klinik te tyre ne baze te standarteve.<br>Duke vleresuar nivelin perfundimtar te specializanteve mendojme se ato do ti pergjigjen tregut te punes.<br>Mendojme se te treja biblotekat e Albanian University ndikojne ne realizimin e programit te specializimit per formimin teorik te specializanteve.<br>Per sa I perket bashkepunimit me spitale private apo publike mendojme qe ne disa raste ishin formale.<br>U pa se specializantet jane te pajisur me police sigurimi nga kompania private Sicred |
| **Standardi V. 6- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e studentëve që kanë përfunduar programet e studimit specializuese afatgjata.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të | U pa se zyra e karrieres kishte te dhena te |

3 Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikulimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.

| | |
|---|---|
| studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit. | nevojshme per mundesite e punesimit te specializanteve |
| **Standardi V. 7- Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3** Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.<br><br>**Kriteri 4** Vlerësimi vjetor i studentëve bëhet sipas moduleve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik. | Ne kete institucion specializanti per pervetesimin e njohurive vleresohej ne vazhdimesi gje qe shprehet ne ndarjen e pikeve gjate gjithe semestrit si per sa I perket formimit teorik, praktik apo provimit perfundimtar.<br><br>Zyra e sigurimit te cilesise se programeve te studimit monitoronte gjate gjithe viotit akademik ralizimin e programeve duke plotesuarformulare vleresimi pas perfundimit te cdo lende, duke organizuar takime me student dhe pedagoge per probleme dhe cilesine e mesimdhenies, per procedurat e vleresimit, per praktiken, detyrat kerkimore etj .<br><br>Pedagoget diskutojne vleresimet qe ju bejne studenteve duke marre ne kosiderate dhe ankimimiet e tyre si dhe ne raste te vecanta pezullimin zgjatjen ose perjashtimin nga studimet e specializmimit<br><br>Vleresimi vjetor i specializantit behet ne baze te moduleve pershtatur me rregulloren e studimit. |
| **Standardi V. 8 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve** | |
| **Kriteri 1** Studenti jep prova që ka fituar:<br>a. Njohuri të thelluara në fushën përkatëse;<br>b. Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të;<br>c. Aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara per zgjidhjen e situatave komplekse;<br>d. Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese;<br>e. Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja;<br>f. Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike;<br>g. Sjellje etike dhe profesionale.<br><br>**Kriteri 2** Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.<br><br>**Kriteri 3** Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues i cili e vlerëson atë pozitivisht ose negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikat dhe modulet e kryera si dhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si | Specializanti testohej ne fusha ku perfshiheshin shkencat mjeksore klinike si në diagnozen diferenciale dhe planin e sakte te trajtimit.<br><br>Per sa I perket vleresimit praktik ai eshte bere duke zgjidhur nje situate klinike nen vleresimin e tutorit.<br><br>Institucioni dispononte te dhena te plota te vleresimit te cdo studenti ne vite ne rruge elektronike dhe me rregjistrat perkates. |

| | |
|---|---|
| dhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar.<br>**Kriteri 4** Vlerësimi përfundimtar i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogeve dhe të udhëheqësit.<br>**Kriteri 5** Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin final të njohurive të marra nga studentët. | |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Nga vleresimi arrijme ne konkluzion se per pranimin e specializanteve nuk kishte konkurs dhe provim pranimi por kjo realizohej ne baze te nje formulari te plotesuar nga aplikanti dhe te kritereve te vendosura, pranimi behej me dosje dhe nje interviste e aplikantit. Mendojme qe ne te ardhmen te shikohet mundesia e pranimit me konkurs paraprak.
2. Per ecurine e veprimtarise mesimore dhe kerkimore te specializantit merrej stafi akademik dhe ai mbeshtetes ku here pas here organizonte takime individuale dhe ne grup per permiresimin e problemeve qe dilnin gjate procesit.
3. Ne kete institucion specializanti per pervetesimin e njohurive vleresohej ne vazhdimesi gje qe shprehet ne ndarjen e pikeve gjate gjithe semestrit si per sa i perket formimit teorik, praktik apo provimit perfundimtar kjo ne baze te standarteve aktuale

## STANDARDI VI - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA

**Pjesa përshkrimore**

U konstatua se kishte tre bibloteka ne Albanian University te cilat kishin literature te mjaftueshme per specializantet per realizmin e programit te studimit .

Bibloteka punonte me orar nga ora 8-19 kjo dhe ne varesi te kerkesave te studenteve apo dhe te sezonit te provimeve

Pas verifikimit rezultoi se institucioni kishte sasi te mjaftueshme te mjeteve audio vizive, klasa me hapsira te pershtatshme dhe mjetet e nevojshme teknologjike, salla konferencash te pajisura kundrejt standarteve.

**Tregues të matshëm:**

☑ Numri i titujve, llojet (monografi, periodikë, library elektronike, etj

Ne bibloteken e Universitetit numerohen rreth 6000 libra, gjithashtu bibloteka online ka rreth 1000 tituj qe jane ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj, biblioteka e Fakutetit te Shkencave Mjeksore punon nga ora 8 deri ne oren 19, dhe studentet sipas nevojave te lendeve te ndryshme kane shfrytezuar tituj te ndryshem dhe te larmishem ne sherbim te ketij specialiteti

☑ Numri i laboratoreve, etj

Ne mjediset per Fakultetin e shkencave mjeksore ka rreth 6 salla leksionesh, 4 klasa seminaresh, 16 salla per praktike profesionale, 5 laboratore etj.

**Vlerësimi sipas standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **STANDARDI VI - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA** | |
| **Standardi VI. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Biblioteka vë në dispozicion të programit të studimit një listë titujsh aktualë të literaturës së detyruar, e cila ndodhet realisht në bibliotekë.<br><br>**Kriteri 2** Biblioteka zotëron një listë të botimeve periodike dhe programeve kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.<br><br>**Kriteri 3** Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.<br><br>**Kriteri 4** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. | U konstatuan se te treja biblotekat e Albanian University kishin literature te mjaftueshme per specializantet per realizmin e programit te studimit.<br><br>Pergjegjesit i Departamentit te Stomatologjise kishte hartuar nje plan te detajuar per zerat qe do te mbuloje biblioteka Questja per te ndihmuar specializantet e programit te studimit te kirurgjise orale.<br><br>Bibloteka punonte me orar nga ora 8-19 kjo dhe ne varesi te kerkesave te studenteve apo dhe te sezonit te provimeve |
| **Standardi VI. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise të përshtatshme mësimore dhe struktura klinike.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka laboratorë, klasa, zyra, studio, auditore dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.<br><br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit, si dhe në përmirësim të vazhdueshëm.<br><br>**Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturat klinike pjesë e rrjetit formues për zhvillimin otimal të programit specializues. | Pas verifikimit rezultoi se institucioni kishte sasi te mjaftueshme te mjeteve audio vizive, klasa me hapsira te pershtatshme dhe mjetet e nevojshme teknologjike, salla konferencash te pajnisura kundrejt standardeve.<br><br>Te gjitha klasat mesimore jane te pasjisura me mjetet audiovizive te nevojshme, me internet ne dispozicion<br><br>Klinika universitare stomatologjike mendojme se ndikon per realizimin e programit te specializimit, ajo ndihmon nepermjet nje sale kirurgjikale dhe radiologjia per diagnozat perkatese. |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br><br>1. Nga verifikimet konkluduam se institucioni ka laboratore, klasa, mjedise mesimore ne perputhje me standartet e kerkuara | |

## STANDARDI VII - INSTITUCIONI DISPONON NJË RREGULLORE TË DETAJUAR TË PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË

**Pjesa përshkrimore**

Rregullorja per organizimin dhe funksionimin e programit te studimit te specializimit ne kirurgjine orale te Albanian University mbeshtej ne ligjin numer 9741 date 21.05.2007 per

arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise (i ndryshuar), me te gjithe aktet normative qe dalin ne zbatim te ligjit mbi statutin e institucionit si dhe rregulloret e tjera te tij.

**Vlerësimi sipas standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **STANDARDI VII - INSTITUCIONI DISPONON NJË RREGULLORE TË DETAJUAR TË PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË** | |
| **Standardi VII. 1- Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe përditësohet çdo vit akademik** | |
| **Kriteri 1** Rregullorja është hartuar në përputhjë me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 2** Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik.<br><br>**Kriteri 3** Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregullorët pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit. | Rregullorja per organizimin dhe funksionimit te programit te studimit te specializimit bne kirurgjine iorale te Albanian University mbeshtet ne ligjin numer 9741 date 21.05.2007 per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise (i ndryshuar), mne te gjithe aktet normative qe dalin ne zbatim te ligjit mbi statutin e institucionit si dhe rregulloret e tjera te tij.<br><br>Rregullorja e studimeve ne kirurgjine orale vendos rregullat normative per kryerjen e studimeve te cikliit te trete per fitimin e titullit mjek specialist ne kirurgjine orale.<br><br>Rregullorja percakton qarte kriteret e pranimit te specializanteve, strukturimin e programit, rregullat e procesit mesimor dhe kerkimor, mbrojtjen e tezes si dhe sanksionet ne rast te shkeljes se rregullores . |
| **Standardi VII. 2- Hartimi dhe miratimi i rregullores ndjek procedurat dhe merr mendimin e institucioneve të ndryshme të parashikuara për këtë qëllim.** | |
| **Kriteri 1** Rregullorja propozohet nga Këshilli i Profesorëve dhe aprovohet nga senati i institucionit që i ofron ato.<br><br>**Kriteri 2** Rregullorja e aprovuar nga senati merr aprovimin nga MSH dhe MASH para hyrjes në fuqi. | Rregullorja e specializimeve eshte propozuar nga keshilli i profesorave dhe aprovuar nga senati i institucionit<br><br>Kjo rregullore ishte derguar ne Ministrine e Arsimit dhe Sporteve por nuk ka asnjë përgjigje per ndryshimin e emrit nga kirurgji ne kirurgji orale |
| **Standardi VII. 3- Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.** | |
| **Kriteri 1** Në regullore janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjësit të programit të specializimit dhe të këshillit drejtues.<br><br>**Kriteri 2** Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij. | Specializimi drejtohej nga drejtuesi i programeve te specializimit ne bashkepunim me kordinatorin.<br><br>Drejtues i programeve te specializimit emerohej nga senati akademik i AU<br><br>Drejtuesi percaktonte nje udheheqes qe eshte pergjegjes per mbarvajtjen e programit te studimit<br><br>Udheheqesi propozonte tutoret per specializantet te cilet ishin mjeke specialiste dhe aprovoheshin nga drejtuesi i specializimeve. |
| **Standardi VII. 4- Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit** | |
| **Kriteri 1** Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe | Dokumentet e kërkuara nga Institucioni për aplikim |

| | |
|---|---|
| titulli i diplomës që kërkohet, nota mesatare, mosha, publikimet e kryera, etj) si dhe kriteret përjashtuese.<br><br>**Kriteri 2** Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.<br><br>**Kriteri 3** Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandididadit për çdo kriter të plotësuar (notë mesatare, publikime, etj) si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi (me shkrim, me gojë, praktik, etj).<br><br>**Kriteri 4** Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumentave.<br><br>**Kriteri 5** Aplikanti dorëzon një kërkesë me shkrim sipas formatit të përcaktuar në rrëgullore dhe që i bashkangjitet asaj. Aplikantit, në momentin e pranimit të dokumentacionit i jepet një vërtetim për aplikimin me numrin e tij identifikues gjatë procesit.<br><br>**Kriteri 6** Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e zhvillimit të testimeve, rradha e zhvillimit të tyre, sa ditë diferencë mund të ketë nga një testim tek tjetri për të njëjtin program dhe për programe të ndryshme specializimi.<br><br>**Kriteri 7** Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit.<br><br>**Kriteri 8** Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.<br><br>**Kriteri 9** Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specializantëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe taksat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.<br><br>**Kriteri 10** Mënyra e vlerësimit dhe argumentet mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.<br><br>**Kriteri 11** Në rregullore është përcatuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.<br><br>**Kriteri 12** Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specializantët fitues. | për pranim ishin si më poshtë:<br>- Diplomë "Master i Shkencave" në Stomatologji<br>- Diplomë tjetër ekuivalente me diplomën e mësipërme, si p.sh: diplomë e sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi (Kopje e noterizuar),<br>- Diplomë e përfituar jashtë vendit, e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme. (Në rastin e një diplome të përfituar në Universitete jashtë vendit duhet të paraqitet njehsimi i saj nga Qendra Kombëtare e njohjes së diplomave dhe e informimit në MAS ose të paraqitet një kërkesë me shkrim drejtuar Institucionit për njohjen e diplomës së përfituar jashtë vendit, por vetëm nga pikëpamja e vazhdimit të studimeve.)<br>- Listë notash të shkollës së lartë; (origjinale ose fotokopje e noterizuar).<br>- CV të detajuar,<br>- Fotokopje e kartës së identitetit,<br>- Dëshmi e marrjes së gjuhës angleze të certifikuar në nivelin internacional, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MAS, (afati i lejueshëm deri në përfundim të programit të studimit)<br>- 3 fotografi pashaporte<br><br>Kriteret e pranimit zhvilloheshin si me siper dhe percaktoheshin nga senati akademik.Ato shpalleshin minimalisht dy jave perpara procesit te pranimit.<br>• Shpallja behet ne ambjentet e universitetit, ne faqen zyrtare te internetit si dhe publikohen ne iorganet e medias.<br>• Numri i kandidateve aplikant ishte i pakufizuar ndersa pranimi behej me konkurim me dosje nga 10-30 persona<br><br>Komisioni perzgjedhes ishte i perbere nga 5 veta i cili ngrihet nga keshilli i fakultetit duke qene eksperte te fushes perkatese te specializmit<br><br>Komosioni zbatonte udhezimet e keshillit te fakultetit dhe drejtuesit te programit te specializimieve<br><br>Komisioni zhvillon procesin e seleksionimit ne menyre profesionale dhe objektive pa perdorur forma diskriminimi dhe favorizimi .<br><br>Komisoni hedh ne procesverbal rezultatet e procesit<br><br>Komisioni i dorezon kordinatorit te gjithe dokumentacionine aplikanteve<br><br>Dokumentet për konkurrim pranohen sipas njoftimit publik për pranimin e aplikimeve. Dokumentet për |

| | |
|---|---|
| | konkurrim dorëzohen nga i interesuari në Sekretarinë e specializimeve;<br><br>Me dorëzimin e dokumenteve, aplikanti merrte një certifikatë aplikimi si dhe informohej në mënyrë të detajuar mbi programin e specializimit. Studenti informohej mbi: kohëzgjatjen e programit të studimit; kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin përfundimtar; mbështetjen që institucioni i siguron studentit nëpërmjet strukturave administrative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (laboratorë, biblioteka, etj.);<br><br>Në rregullore në nenin 30 - 34 është përcaktuar mënyra e zhvillimin të testimeve në programin e studimit të specializimeve ne kirurgji orale.<br><br>Në rregullore ishte përcaktuar mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimeve dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit neni 20 dhe 21.<br><br>Komisioni zbaton udhëzimet e Këshillit të Fakultetit dhe të Drejtuesit te Programit te Specializimeve lidhur me zhvillimin e procesit të seleksionimit.<br><br>1) Komisioni duhet të zhvillojë procesin e seleksionimit në mënyrë profesionale dhe objektive, pa përdorur forma diskriminimi dhe favorizimi.<br><br>2) Komisioni hedh në procesverbal rezultatet e procesit të seleksionimit.<br><br>3) Komisioni i dorëzon Koordinatorit të gjithë dokumentacionin e aplikantëve.<br><br>Kandidati që regjistrohej ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik përkatës, nëse dorëzon brenda afateve të shpallura të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik si dhe nënshkruan kontratën e regjistrimit më institucionin; kështu ai fiton statusin e studentit.<br><br>Fitues shpalleshin kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.<br><br>Në këtë fazë departamenti bën publike rezultatet dhe i komunikon fituesve afatet e regjistrimit. Aplikanti fiton statusin e specializantit me përfundimin e procedurave të regjistrimit.<br><br>Në rregullore është përcaktuar qartazi në nenin 21 dhe 22 të saj mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve;<br><br>Në rregulloren e programit të studimit të specializimit është përcaktuar e detajuar se si ndodh procesi i regjistrimit të studentit (në nenin 24 të |

| | |
|---|---|
| | rregullores). |
| **Standardi VII. 5- Në rregullore parashikohen plani i çdo programi specializues, frekuentimi i tyre, transferimet e studenteve.** | |
| **Kriteri 1** Plani i detajuar i çdo programi specializues, lëndët dhe praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyet, leja e lindjes, dhe mënyra e rekuperimit të mungesave duhet të jenë të parashikuara në rregulloren e specializimeve.<br><br>**Kriteri 2** Parashikohen procedurat për transferimet për apo nga programe te tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.<br><br>**Kriteri 3** Parashikohen kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit nga studimet specializuese.<br><br>**Kriteri 4** Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues (për shembull institucionet jashtë vendit), kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës. | Programi mësimor në vitin e parë ishte i organizuar në dy semestra, në përfundim të të cilit studenti fitonte 60 kredite.<br><br>Gjatë këtij viti zhvilloheshin një total prej 1500 orësh mësimore, 612 prej të cilave janë orë në auditor dhe praktikë klinike dhe 888 orët e tjera, të shpërndara gjatë vitit akademik, janë orë studimi individual.<br><br>Nga këto 360 orë i takojnë praktikës klinike dhe 252 orë në auditor i takonin moduleve teorike që përbëjnë kurset e integruara. AU mundësonte transferimin e specializanteve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të tretë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejonte transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.<br><br>Studenti lejohej të regjistrohej në vitin pasardhës kur kishte fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës.<br><br>Në nenin 25 të rregullores së programit të studimit përcaktohet qartazi mundësitë e transferimit të studentëve brenda dhe jashtë vendit për të vazhduar më tej programet specializuese në të njëjtën fushë apo edhe në fusha të ngjashme. |
| **Standardi VII. 6- Në rregullore parashikohet libreza e studentit, tipologia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të provimeve.** | |
